



# **VIZIONI I SË ARDHMES SË SISTEMIT KOMBËTAR TË PAGESAVE**

**KORRIK 2009**

## TABELA E PËRMBAJTJES

<b>PARATHËNIE .....</b>	<b>2</b>
<b>PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE .....</b>	<b>2</b>
<b>II. HYRJA DHE PREZANTIMI .....</b>	<b>7</b>
STRUKTURA INSTITUCIONALE DHE AJO E TREGUT .....	8
AMBIENTI LIGJOR .....	11
INSTRUMENTET E PAGESAVE .....	13
KLIRINGU DHE SHLYERJA .....	16
TRANSAKSIONET Ë QEVERISË .....	19
LETRAT ME VLERË .....	21
<b>III. PËRKUFIZIMI I STRATEGJISË SË SISTEMIT TË PAGESAVE.....</b>	<b>23</b>
ROLI I NJË SISTEMI KOMBËTAR PAGESASH.....	24
QËLLIMI DHE KOMPONENTËT E NJË SKP .....	25
KORNIZA MBI KONCEPTIMIN E PUNËS PËR HARTIMIN E SKP.....	25
<b>IV. SHTYLLAT E VIZIONIT TË SISTEMIT TË PAGESAVE .....</b>	<b>29</b>
SHTYLLA I. KORNIZA LIGJORE E PUNËS .....	29
SHTYLLA II. PAGESAT ME VLERË TË MADHE DHE ATO URGJENTE .....	31
SHTYLLA III. SISTEMI I PAGESAVE ME VLERA TË VOGLA.....	33
SHTYLLA IV. TRANSAKSIONET QEVERITARE.....	36
SHTYLLA V. DEPOZITA E LETRAVE ME VLERË, KLIRINGU DHE SHLYERJA .....	37
SHTYLLA VI. TREGJET MONETARE.....	40
SHTYLLA VII. DËRGESAT NDËRKOMBËTARE .....	41
SHTYLLA VIII. MBIKËQYRJA .....	42
SHTYLLA IX. BASHKËPUNIMI .....	46
<b>NENI II. SHTOJCAT.....</b>	<b>48</b>
SHTOJCA 1: MODELI PËR KËSHILLIN KOMBËTAR TË PAGESAVE – KUSHTET E REFERIMIT .....	49
SHTOJCA 2: KSRRP - PARIMET THEMELORE PËR SISTEMET E PAGESAVE SISTEMATIKISHT TË RËNDËSISHME DHE PËRGJEGJËSITË QË KANË TË BËJNË ME BANKËN QENDRORE .....	51
SHTOJCA 3: KSRRP-ONKL - REKOMANDIMET PËR SISTEMET E PAGESAVE TË LETRAVE ME VLERË..	52
SHTOJCA 4: KSRRP – PARIMET E PËRGJITHSHME TË BANKËS BOTËRORE PËR SHËRBIMET E DËRGESAVE NDËRKOMBËTARE DHE ROLET QË NDËRLIDHEN ME TO .....	54
SHTOJCA 5: SYNIMET E INTERESIT PUBLIK, VEPRIMET MINIMALE TË BANKËS QENDRORE DHE SFERA E VEPRIMEVE TË MUNDSHME PLOTËSUESE PËR SISTEMET E PAGESAVE ME PAKICË .....	55
<b>NENI III. LISTA E SHKURTESAVE.....</b>	<b>57</b>

## PARATHËNIE

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) e njeh mirë rëndësinë e një qasjeje strategjike për zhvillimin e sistemit kombëtar të pagesave (SKP) prandaj ka përgatitur një vizion për Sistemin Kombëtar të Pagesave në të ardhmen (vizionin) dhe planin e veprimit për zbatimin e vizionit të Sistemit Kombëtar të Pagesave (plani i veprimit). Këto dy dokumente bëjnë të qartë strategjinë për zhvillimin e SKP-së në Republikën e Kosovës. Vizioni ofron informacion të përgjithshëm mbi sistemin kombëtar aktual të pagesave, përkufizon strategjinë e Sistemit të Pagesave si dhe parashikon gjendjen e planifikuar në të ardhmen e SKP-së në Kosovë në bazë të elementeve specifike të saj. Në tërë përmbytjen e saj, parimet dhe praktikët e pranuar ndërkomtarisht janë theksuar dhe përgatitur sipas perspektivës së rrethanave të veçanta në Kosovë. Plani i veprimit plotëson vizionin dhe përmban detaje praktike mbi zbatimin e projekteve të veçanta zhvillimore të cilat nevojiten për të arritur SKP të parashikuar.

Ky dokument paraqet vizionin. Përgatitja e tij është udhëhequr nga BQK-ja, por është realizuar në bazë të konsultimeve të shumta dhe të vazhdueshme me të gjithë sektorin dhe me të gjitha grupet e prekura të interesit. Gjithashtu, kontributi i vazhdueshëm i ofruar nga misioni për ndihmë teknike i Bankës Botërore ka qenë domethënës.

## PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Sistemi Kombëtar i Pagesave (SKP) i një vendi përfshin çdo gjë që ka të bëjë me lëvizjen e parasë nga paguesi te i paguari, duke mbuluar të gjitha fazat e pagesës nga oferta fillestare e një instrumenti të pagesës deri tek shlyerja përfundimtare. Sipas fjalorit të Komitetit mbi sistemet e pagesave dhe të shlyerjes (KSPSH)/ Banka për Shlyerje Ndërkombëtare (BSHN)<sup>1</sup>:

*“Ajo përfshin të gjithë matricën e një vendi, të marrëveshjeve institucionale dhe infrastrukturale si dhe proceset për të inicuar dhe transferuar kërkesat monetare në trajtën e borxheve të bankave komerciale dhe Bankës Qendrore.... elementet kryesore të një sistemi kombëtar të pagesave janë:*

- *Instrumentet e pagesave që përdoren për të inicuar dhe drejtuar transferimin e fondeve në mes të llogarive të paguesit dhe të paguarit në institucionet financiare; infrastrukturat e pagesave për kryerjen dhe klirimin e instrumenteve të pagesave, përpunimin dhe komunikimin e informacionit të pagesave, si dhe transferimin e fondeve ndërmjet institucioneve që paguajnë dhe atyre që pranojnë pagesën;*
- *Institucionet financiare që ofrojnë llogari, instrumente dhe shërbime pagesash për konsumatorët, si dhe bizneset dhe organizatat të cilat operojnë dhe ofrojnë rrjete të shërbimeve për kryerjen e pagesave, kliringut dhe shlyerjes së këtyre institucioneve financiare;*

<sup>1</sup> CPSS/BIS 2006: *General guidance for national payment system development*

- *Marrëveshjet e tregut si konventat, rregulloret dhe kontratat për prodhimin, caktim e çmimeve, shpërndarjen dhe marrjen e instrumenteve dhe shërbimeve të ndryshme të pagesave;*
- *Ligjet, standardet, rregullat dhe procedurat e caktuara nga ligjvënësit, gjykatat dhe rregullatorët që përcaktojnë dhe udhëheqin mekanizmat e procesit të transferimit të pagesave si dhe sjelljen e tregjeve të shërbimit të pagesave.”*

Në përputhje me objektivat dhe me kompetencat e veçanta që i jep Ligji i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, BQK-ja ka zbankuar mbi një proces strategjik për të modernizuar SKP në Kosovë, me synim që ta sjellë atë në nivelin e praktikave më të mira ndërkombëtare. Projekti është përkrahur shumë mirë nga komuniteti financiar në Kosovë, ku në përgjithësi ekziston një dëshirë dhe përkrahje e fortë për zhvillimin e një SKP koherente, efikase, të sigurt, të përshtatshme dhe të integruar, duke njohur potencialin stimulues të tij në rritjen e ekonomisë si dhe promovimin e integritetit rajonal dhe ndërkombëtar. Gjithashtu komuniteti financiar është i interesuar që BQK-ja të udhëheq zhvillimin e SKP. Strategjia për zhvillimin e SKP është bërë e ditur në dy dokumente, përkatësisht: (i) Vizioni i Sistemit Kombëtar të Pagesave në të Ardhmen (Vizioni); dhe (ii) Plani i Veprimit për zbatimin e vizionit të Sistemit Kombëtar të Pagesave (Plani i Veprimit). Dokumenti i mëtutjeshëm është në përputhje me këtë vizion.

Ky vizion përmban tri pjesë kryesore përveç (pjesës I) që është përmbledhje ekzekutive:

- Pjesa II (Hyrja dhe Prezantimi) ofron një paraqitje të gjendjes momentale të sistemit të pagesave në Kosovë, duke përfshirë statistikën relevante, si bazë për zhvillimin e vizionit. Mbulon të gjitha aspektet e situatës aktuale, duke përfshirë institucionet, ambientin ligjor, instrumentet e pagesave, marrëveshjet për kliring dhe shlyerje, transaksionet qeveritare dhe si përfundim planet për paraqitjen e letrave me vlerë nga qeveria.
- Pjesa III (Përkufizimi i Strategjisë së Sistemit të Pagesave) nxjerr në pah qasjen strategjike të BQK-së ndaj zhvillimit të SKP.
- Pjesa IV (Shtyllat e Vizionit të Sistemit të Pagesave) thekson gjendjen e planifikuar për SKP të Kosovës në të ardhmen në termat e nëntë shtyllave të cilat së bashku i përmbushin plotësisht të gjitha elementet e SKP. Për secilën nga nëntë shtyllat, pjesa IV shpjegon shkurt parimet në të cilat bazohet secila shtyllë si dhe thekson gjendjen e dëshiruar për të ardhmen e SKP të Kosovës në kontekstin e secilës shtyllë në veçanti.

Për të përmbushur vizionin do të nevojitet zbatimi i një sërë projektesh zhvillimore individuale. Këto shpjegohen në termat e secilës shtyllë veç e veç por në lidhje me planin e veprimit, i cili përmban detaje praktike të çdo projekti.

Nëntë shtyllat janë si vijon:

**Shtylla I: Korniza Ligjore**

BQK-ja do të sigurojë që SKP mbështetet plotësisht në një sistem ligjor të fortë e të kompletuar ndaj edhe ka filluar një program për të ekzaminuar legjislacionin dhe rregullat aktuale me qëllim që të zhvillojë dhe të nxjerrë ndonjë rregullore të re apo të përmirësuar sipas nevojës.

**Shtylla II: Pagesat me vlerë të madhe dhe ato urgjente**

Sistemet për përpunimin e pagesave me vlera të mëdha dhe atyre urgjente janë komponentët më të rëndësishme të SKP. Këto janë përkufizuar si sisteme pagesash sistematikisht të rëndësishme (SPSR), sepse janë në gjendje të gjenerojnë dhe transmetojnë çrregullime sistemike në sektorin financiar. Për momentin këto pagesa po trajtohen si pagesa prioritare në Sistemin Elektronik të Kliringut Ndërbankar të BQK-së (SEKN), i cili paraqet disa elemente të rrezikut, kryesisht sepse realizimi i këtyre pagesave nuk bëhet në kohë reale.

Është me rëndësi që të vendoset në funksion një sistem adekuat për kliring dhe shlyerje të pagesave me vlera të mëdha dhe atyre urgjente. Për këtë arsye BQK-ja po synon të përftojë dhe të zbatojë shlyerjen bruto në kohe reale (RTGS) brenda sistemit të përgjithshëm operativ të pagesave në BQK, i cili ka për qëllim të përfaqësojë shtyllën kryesore të SKP në Kosovë si dhe të zëvendësojë sistemin aktual të kliringut dhe shlyerjes për pagesat *prioritare* në SEKN. Sistemi RTGS do të integrohet në mënyrë të sigurt dhe efikase drejtpërdrejt me sistemet e tjera, duke përfshirë sistemet e brendshme që operohen nga bankat komerciale dhe çdo sistem tjetër për kliringun e pagesave me pakicë (përfshirë edhe SEKN nëse vendoset që të vazhdohet me përdorimin e tij – shih shtylla III). Për të arritur këtë, do të përdoren ndërlydhje të duhura. Sistemi SEKN do të jetë gjithashtu i integruar me të gjitha sistemet e ardhshme për shlyerjen e letrave me vlerë, që të arrihet Delivery versus Payment (DvP)(Shpërndarje kundrejt Pagesës)(SHkP), dhe brenda sistemit të tregut ndërbankar të arrihet Payment versus Payment (PvP) (Pagesën kundrejt Pagesës -PkP).

**Shtylla III: Sistemet e pagesave me vlera të vogla**

Për të gjitha pagesat elektronike ndërbankare për momentin kliringu bëhet nëpërmjet sistemit SEKN që u përmend më lart, i cili merret me pagesat prioritare (me shuma të mëdha dhe atyre urgjente), pagesat individuale (kreditimi direkt), pagesat në grumbull/masivë, pagesat Kos-Xhiro dhe debitimet direkte (të cilat për momentin janë në fazën testuese). SEKN për momentin ofron një nivel të kënaqshëm të funksionimit dhe shërbimit për komunitetin e pagesave në Kosovë. Si pjesë e projektit për të prezantuar një sistem RTGS, BQK-ja do të vlerësojë nëse do të mbajë SEKN apo do ta zëvendësojë atë me një funksion të integruar për pagesat me pakicë i cili mund të ofrohet brenda pakos softuerike të RTGS dhe që do t'i ofrojë SEKN-it se paku një funksionim ekuivalent.

Marrëveshjet momentale për regjistrim dhe kliring të pagesave me kartela (debiti dhe krediti) nuk janë të kënaqshme sepse secila bankë operon rrjetin e vet të terminaleve ATM-ve dhe POS-ve, pa asnjë marrëveshje vendore ndëroperimi. Shlyerja e transaksioneve me kartela vendore kryhet në një masë të madhe nëpërmjet qarqeve ndërkombëtare. BQK-ja do të luajë një rol katalizues për të nxjerrë kartën kombëtare ndërbankare e cila do të ofrojë ndëroperimin e kërkuar, dhe do të zbatohet nga sektori bankar në baza të paanësisë dhe mosdiskriminimit si dhe me pjesëmarrjen e kërkuar të të gjithë lëshuesve e kartelave bankare. Kjo do të lidhet me sistemin RTGS për shlyerjen e transaksioneve me kartela vendore.

#### **Shtylla IV: Transaksionet Qeveritare**

Transaksionet qeveritare (pagesat hyrëse dhe dalëse) procesohen nëpërmjet SEKN. Marrëveshjet momentale janë kryesisht të kënaqshme, megjithatë janë parashikuar disa përmirësime. Këto përfshijnë krijimin e një lidhjeje elektronike direkte ndërmjet Departamentit të Thesarit në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave (Thesarit) dhe BQK-së për automatizimin e dërgimit të urdhër pagesave, si dhe themelimin e një grupi pune të përbashkët për të vlerësuar mënyrat e përmirësimit të efikasitetit dhe lehtësimit në mbledhjen e të hyrave. Në një periudhë afatmesme, Ministria e Administratës Publike (MAP) planifikon të krijojë një portal elektronik të pagesave “one-stop” për t’ju mundësuar qytetarëve dhe organizatave për të realizuar pagesat e të gjitha llojeve ndaj Qeverisë. BQK-ja do të bashkëpunojë me MAP-në sipas nevojës.

#### **Shtylla V: Letrat me Vlerë, Depozitimi, Kliringu dhe Shlyerja**

Për momentin Qeveria nuk lëshon letra me vlerë, por është në proces të planifikimit për ta bërë këtë, dhe ndoshta starton në fillim apo në mes të vitit 2011 me bono thesar afatshkurtër. Thesari po fillon me aktivitetet e nevojshme për t’u përgatitur për prezantimin e instrumenteve të borxhit qeveritar. BQK-ja do të instalojë një bazë kompjuterike të quajtur sistemi Qendror i Depozitimit të Letrave me Vlerë për të ofruar funksionimin e duhur në përkrahje të Thesarit dhe veprimtarisë së tij në lidhje me borxhet vendore. Kjo do të ndërlidhet me një sistem ankandi për veprimtaritë e tregjeve primare (që bëjnë lëshimin e letrave me vlerë), si dhe do të lidhet ngushtë me sistemin RTGS (shih shtyllën II) për këto qëllime (i) zbatimin e veprimtarive SHkP për shlyerjen e të gjitha transaksioneve të letrave me vlerë dhe (ii) për të përkrahur (kolateralizuar) veprimtaritë që ndihmojnë likuiditetin brenda ditës në sistemin RTGS të BQK-së.

Në mënyrë që të reduktohet mundësia për konfuzion gjatë periudhës delikate të prezantimit të instrumenteve vendore të borxhit, BQK-ja do të hartojë një kornizë rigoroze rregullative dhe të mbikëqyrjes së sistemeve të depozitimit dhe shlyerjes së letrave me vlerë. Kjo do të realizohet në bazë të konsultimit me grupet e tjera të interesit.

#### **Shtylla VI: Tregjet Monetare**

Për momentin nuk ka një treg monetar ndërbankar të zhvilluar, dhe çdo marrëveshje e arritur është realizuar në bazë dypalëshe dhe/ose në baza over the counter (OTC) (marrëveshje direkte në mes të dy palëve). Në një periudhë afatmesme, BQK-ja do të kërkojë të themelojë në Kosovë një treg monetar ndërbankar bashkëkohorë, i cili do të shërbejë si një element i rëndësishëm për menaxhimin e likuiditetit, si në periudhën afatshkurtër ashtu edhe në atë afatmesme BQK do të ndërmarrë masat e nevojshme për të forcuar tregun monetar ndërbankar.

### **Shtylla VII: Dërgesat nga Jashtë**

Dërgesat e emigranteve përbejnë një element të rëndësishëm të të ardhurave kombëtare, por natyra e tyre apo mënyra e pagimit duhet të studiohen më tej. Për një kohë shumë të shkurtër BQK do të ndërmarrë një detyrë mbi marrjen e fondeve krahas për krahas me KSPU/Bankën Botërore *Parimet Bazë për Shërbimet Ndërkombëtare të Dërgesave*, si dhe do të identifikojë në detaje masat specifike që duhen ndërmarrë në lidhje me sistemin tashmë ekzistues dhe të planifikuar të pagesave në Kosovë. Synimi më i madh do të ishte të nxitej përdorimi sa më efikas i infrastrukturës së paraparë të pagesave në Kosovë, duke përfshirë atë të institucioneve bankare dhe jobankare.

BQK do të sigurohet që perspektiva rregullatore mbulon çështjet në lidhje me sistemin e pagesave, në veçanti efikasitetin, transparencën dhe menaxhimin e rrezikut përveç çështjeve “tradicionale” të bilancit të pagesave dhe pastrimit të parave. Përfundimisht, në bashkëpunim me autoritete të tjera, do të merret vendim nëse nevojiten rregullore të reja për të nxitur masa më të sigurta dhe më efektive për shërbimin në këto fusha si dhe për mbrojtjen e konsumatorëve.

### **Shtylla VIII: Mbikëqyrja**

BQK ka ndërmend ta ushtrojë si duhet funksionin e mbikëqyrjes së sistemit të pagesave në Kosovë duke u bazuar në fuqinë që tashmë i jep Ligji i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës. Për këtë ajo do të themelojë një njësi të mbikëqyrjes funksioni i së cilës do të jetë: (i) të sigurojë se ekziston bashkëpunimi në shkallën e duhur i pjesëmarrësve; (ii) të verifikojë se sistemi individual i pagesave i përmbush nevojat e përdoruesve si dhe kërkesat e riskut dhe efikasitetit; (iii) të përcaktojë dhe ndërmarrë masat e nevojshme nëse pjesëmarrësit nuk ju binden normave dhe rregullave të publikuara; dhe (iv) të mbledhin dhe shpërndajnë informata relevante statistikore.

### **Shtylla IX: Bashkëpunimi**

Bashkëpunimi efikas ndërmjet pjesëmarrësve të tregut, ndërmjet rregullatorëve dhe pjesëmarrësve të tregut si dhe ndërmjet vet rregullatorëve është thelbësor për krijimin e një sistemi të shëndosh dhe efikas pagesash. Në veçanti elementi i tërthortë që karakterizon transferimin e parave dhe natyrën sistematike të procedurave të ndërvarura operative e bën sistemin e pagesave një “institucion” ekzistenca dhe funksionim i rregullt i të cilit kërkon bashkëpunim efikas midis pjesëmarrësve.

Në mënyrë që të nxitet një nivel i lartë bashkëpunimi ndërmjet grupeve të interesit, nën udhëheqjen e BQK-së do të krijohet Këshilli Kombëtar i Pagesave (KKP). Ky organ duhet të përfshijë zyrtarë të lartë të ekzekutivit nga të gjitha bankat komerciale si dhe anëtare të grupit të interesit të interesuar në përmirësimin e sistemit të kliringut dhe shlyerjes së pagesave dhe letrave me vlerë, dhe ky do të ishte një mjet tepër i nevojshëm për të realizuar biseda konstruktive ndërmjet tyre.

## II. HYRJA DHE PREZANTIMI

Korniza e punës së sistemit të pagesave në Kosovë është e hartuar relativisht mirë në krahasim me shumë ekonomi të tjera të të njëjtit niveli. Kjo reflekton si eksperiencë e të kaluarës edhe përpjekjet që janë bërë që prej vitit 1999, gjatë qeverisjes së UNMIK-ut e më tej pas pavarësisë, për të ndërtuar një sektor financiar të bazuar në treg dhe për të krijuar institucione dhe procedura të pavarura dhe të përshtatshme për vendin. Megjithatë në një raport të misionit të FMN-së në tetor të vitit 2006 u vërejtën disa dobësi dhe fusha që kanë nevojë për zhvillim të mëtejshëm të një infrastrukture pagesash moderne dhe me kosto të ulët:

1. Përmasat e vogla të shtetit të cilat reduktojnë ekonominë (ky është një faktor i endogjen për te cilin kuptohet nuk mund të merren masa direkte);
2. Mungesa e bashkëpunimit substancial në sektorin bankar;
3. Konkurrenca e kufizuar në industrinë bankare e cila ka sjell zhvillim të ngadaltë të shërbimeve dhe strukturave konkurruese të taksave;
4. Prioriteti relativisht i ulët që i ka kushtuar sektorit bankar zhvillimit të shërbimeve dhe produkteve atraktive për klasat me të ardhura të pakta dhe të mesme;
5. Mungesa e një plani strategjik për zhvillimin e infrastrukturës;
6. Mungesa e një platforme për diskutim të planit strategjik me të gjitha grupet relevante të interesit.

Për me tepër, ndërkohë që statistikatat bankare tregojnë se shumica e anëtarëve të rritur të popullsisë posedojnë llogari bankare, pjesa më e madhe e transaksionit të pagesave ende bëhet duke përdorur para në dore. Kjo përfshin edhe pagesat gjysme elektronike që realizohen duke përdorur Kos-Giro, të cilat po përdoren gjerësisht për pagesat e nevojshme por për të cilat zakonisht paguhet në para. Llogaritë bankare duket se përgjithësisht përdoren për tërheqjen e parave për të realizuar pagesa se sa për pagesa tërësisht elektronike. Çeçet nuk përdoren fare, ose në bazë ndërbankare shumë të kufizuar. Gjithashtu ekzistojnë elemente të rrezikut, sidomos rreziku i shlyerjeve apo rreziku i sistemit, prezent në marrëveshjet aktuale për klerimin dhe shlyerjen e pagesave me vlera të mëdha dhe transaksioneve me kartelë.

Këtu mund të përmendim gjithashtu që për momentin (fillimi 2009) ka një nivel të mirë likuiditeti në ekonomi. Qeveria e Republikës së Kosovës ka mjaft fonde shtesë, shumica e të cilave përmes BQK-së janë investuar në instrumente të tregut monetar në



vendet e UE. Përndryshe të gjitha bankat kanë rezerva të majme të cilat përsëri përgjithësisht investohen jashtë, zakonisht përmes institucioneve të huaja mëmë. Ekziston një shqetësim për një sërë tremujorësh për të cilët situata e favorshme momentale e likuidimit nuk është shfrytëzuar sa duhet për të zhvilluar ekonominë, por këto fonde janë investuar thjesht në ato që shihet se janë mjete të sigurta ndërkombëtare. Kjo tregon se gjendja e tregjeve financiare kombëtare është e pa zhvilluar dhe si Thesari edhe BQK-ja janë të interesuar ta zgjidhin këtë situatë.

Në mënyrë që të zgjidhet çështja më lart dhe probleme të tjera dhe të ndërtohet një platformë e mirë dhe koherente për zhvillimet në të ardhmen, BQK-ja ka vendosur të përvetësojë një qasje strategjike ndaj zhvillimit të SKP-së. Ky dokument përmban vizionin i cili është hartuar në përputhje me qasjen strategjike, ashtu si përshkruhet në pjesën e II. Pjesa tjetër e kësaj (pjesë II) ofron një kornizë të gjendjes ekzistuese të SKP-së si dhe në fillim të 2009.

## STRUKTURA INSTITUCIONALE DHE AJO E TREGUT

### Banka Qendrore e Republikës se Kosovës (BQK)

Pas shpalljes së Pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt 2008, u themelua BQK, bazuar në Ligjin nr. 03/L-074 *Mbi Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës* si një institucion i pavarur i cili i raporton Kuvendit të Republikës së Kosovës. Ajo është pasuese e Autoritet Qendror Bankar të Kosovës (AQBK), i cili ishte themeluar me Rregulloren e UNMK-ut 2006/47, më 24 gusht 2006, si pasuese e Autoritetit Bankar dhe të Pagesave të Kosovës (ABPK). BQK udhëhiqet nga Guvernatori, i cili është përgjigjes ndaj Bordit Drejtues. Guvernatorit i raportojnë dy zëvendësguvernatorë njëri prej të cilëve është përgjegjës për mbikëqyrjen e institucioneve financiare dhe tjetri për funksionet qendrore bankare, si dhe inspektori i përgjithshëm i cili është përgjegjës për Komitetin e Auditimit nën Bordin Drejtues.

Në ligjin e Bankës Qendrore objektivat themelore të BQK-së janë përcaktuar të jenë:

*“a) të ruhet fuqia, aftësia paguese dhe funksionimi efikas i një sistemi stabil të bazuar në treg, duke inkurajuar krijimin e instrumenteve të sigurta financiare; dhe*

*b) pa ndonjë paragjykim, të përkrah politikat e përgjithshme në Kosovë për të kontribuar në një alokim efikas të burimeve në pajtim me principet e një ekonomie me treg të hapur.”*

Për sa ju përket sistemeve të pagesave, ligji i jep BQK-së të drejtën specifike:

*“Të formulojë dhe të zbatojë masat, të kundërshtojë dhe të rregullojë sistemet e pagesave për transaksionet në valutë vendore dhe të huaj në Kosovë,” dhe*

*“të posedojë dhe të operojë një ose më shumë sisteme pagesash”.*

BQK gjithashtu ka të drejtë të licencojë, mbikëqyrë dhe rregullojë te gjitha institucionet financiare. Këtu përfshihen bankat, kompanitë mikro-financiare, kompanitë e sigurimeve, operatorët e transferimit të parave, kompanitë e investimeve, këmbyesit valutore, ndërmjetësuesit-agjentët e shitjes dhe fondet e përbashkëta. Nuk ka asnjë agjenci tjetër rregullatore apo mbikëqyrëse në sektorin financiar.

Brenda BQK-së Drejtorati Ndërbankar i Sistemit të Pagesave është kryesisht përgjegjës për veprimtarinë e SEKN-së, i cili është një sistem ndërbankar pagesash hibrid që realizon një sërë instrumentesh pagesash duke përfshirë ato me afat (prioritar). SEKN përshkruhet në detaje më poshtë. Ky drejtorat është gjithashtu i ngarkuar me detyrën e zhvillimit më tej të SEKN dhe futjen e sistemeve dhe instrumenteve të reja sipas nevojës së grupeve të interesit. Sipas Planit të Biznesit të BQK për 2007-2009, objektivat kryesore të këtij sektori janë:

- *“te ruaje zhvillimin e sistemit nder-bankar te pagesave ne mënyrë qe... te risë fushën e shërbimeve ekzistuese ndaj komunitetit të pagesave” dhe*
- *“të përkrahë praktikën e pagesave bankare jo-kesh”.*

Detyra specifike të këtij drejtorati të përcaktuara në këtë plan-biznesi përfshijnë formulimin e një strategjie të pagesave dhe themelimin e një organi pagesash për qëllime këshillimi dhe koordinimi.

### **Regjistri i Kredive Kosove (RKK)**

BQK operon një sistem të regjistrimit të kredive – Regjistri i Kredive të Kosovës (RKK) – i cili është krijuar në vend dhe u vu në punë në janar 2006. Të gjitha bankat komerciale dhe institucionet kredi-dhënëse janë anëtare të RKK. Është detyrë e të gjitha këtyre institucioneve të raportojnë të gjitha marrëveshjet për dhënie kredie në RKK. Informacioni raportohet vetëm në kreditë e dhëna, sesa në aplikacionet për kredi. Raporte individuale mbi kreditë mund të merren qoftë nga institucioni që ofron kredi qoftë nga subjekti kredimarrës.

### **Sektori Bankar**

Për momentin nga BQK janë tetë banka të licencuara, prej tyre dy janë vendore dhe gjashtë janë të huaja.

Tabela më poshtë tregon detajet bazë të bankave momentalisht të licencuara dhe në funksion.

<b>Banka</b>	<b>Shkurtesa.</b>	<b>Pronësia</b>	<b>Nr. i degëve &amp; nëndegëve</b>
Banka për Biznes	BpB	Vendore	38
Banka Ekonomike	BE	Vendore	36
Banka Kombëtare Tregtare	BKT	Shqiptare	10
Komercijalna Banka	KB	Serbe	8

Nova Ljubljanska Banka	NLB	Silovene	70
ProCredit Bank	PCB	Gjermane	59
Raiffeisen Bank	RBKO	Austriake	50
Turk Ekonomik Bank (ne partneritet me BNP Paribas)	TEB	Turko-Franceze	17

Burimi: BQK

Në katër mujorin e tretë të vitit 2008, numri i përgjithshëm i llogarive bankare, përfshirë llogaritë rrjedhëse, ato të kursimeve dhe depozitave, në të gjitha bankat ishte 1,134,865<sup>2</sup>. Kjo është sa rreth gjysma e popullatës së përgjithshme të Kosovës, e cila tregon se një pjesë e madhe sidomos e popullsisë së rritur posedojnë llogari bankare. Numri i madh i llogarive pjesërisht justifikohet nga fakti se të gjitha rrogat me buxhet shtetëror, pensionet dhe kontributet sociale jepen përmes llogarisë bankare. Gjithsesi shumica e llogarive bankare duket se përdoren vetëm për tërheqje të parave, gjë e cila nga shumica përdoret për pagesë të transaksioneve (shih tek “Instrumentet e Pagesave” më poshtë).

Për të lehtësuar veprimtarinë e SEKN (shih më poshtë) dhe ecurinë e urdhërpagesave në përgjithësi, në vitin 2002, numërimi i llogarive bankare u standardizua. Informacioni mbi formimin e këtyre numrave të llogarive mund të gjendet në ueb-faqen e BQK-së.

### **Shoqata e Bankiereve të Kosovës (SHBK)**

SHBK u themelua në vitin 2003. Ajo vepron si zëri i sektorit bankar dhe si forum ku bankat mund të debatojnë mbi çështje para se t’i diskutojnë ato me BQK-në . Kjo shoqatë gjithashtu realizon një program të mirë trajnues.

### **Institucione Mikrofinanciare**

Industria mikrofinanciare filloi në vitin 1999 si një projekt i zhvillimit ekonomik. Janë 14 institucione mikrofinanciare (IMF), nëntë më të mëdhatë prej të cilave janë anëtarë të Shoqatës së Institucioneve Mikrofinanciare të Kosovës (SHIMK). Nëntë anëtarët e SHIMK kanë një portofolio të përgjithshëm prej rreth 80 milionë €, ndërsa katër të tjerat kanë një total prej rreth 500,000 €. Nën rregulloren 2008/28 të UNMIK-ut *Mbi Regjistrimin, Licencimin, Mbikëqyrjen dhe Rregulloren e Institucioneve Mikrofinanciare*, të gjitha IMF janë licencuar nga BQK ose si Organizata Jo-Qeveritare (OJQ) ose si kompani. Me një përjashtim të gjitha IMF të tjera janë regjistruar si OJQ dhe pothuajse të gjitha kanë QJO ndërkombëtare (organizata ndihme) si kompani mëmë. Pesë IMF janë për momentin në proces të aplikimit në BQK për t’u licencuar si institucione mbajtësdëpozitash.

Anëtarët e SHIMK kanë në tërësi rreth 50,000 klientë, pothuajse të gjithë prej tyre janë nga zonat rurale. Shuma e kredive varion prej më pak se 100 € deri tek 80,000 €

<sup>2</sup> Burimi: ueb-faqe e BQK ( <http://www.bqk-kos.org/ICS/Quartal.pdf>)

në varësi të institucionit dhe llojit të kredisë. Kreditë zakonisht tërhiqen në formë të çeqeve (intrabankare) në bankën e IMF dhe u jepen klientëve direkt në kesh. Pagesat e kredisë bëhen pothuajse të gjitha në para në llogarinë bankare të IMF-së. Shumë prej IMF-ve janë të interesuara të gjejnë metoda më të leverdishme, më efikase dhe më pak të kushtueshme për pagesën e kredisë.

### **Kompanitë e Sigurimit**

Për momentin janë dhjetë kompani sigurimi të licencuara dhe në veprim. Edhe pse ato ofrojnë një sërë produktesh, 90% e tregut varet nga (TPL) sigurimi i automjeteve, prej të cilit shitën rreth 220,000 polica në vit që gjenerojnë një prim të ardhurash prej rreth 30 milionë €. Primi paguhet në bazë vjetore në llogarite bankare, me anë të Kos-Giro. Për momentin vetëm një kompani është e licencuar të ofrojë sigurimin e jetës. Të gjitha kompanitë e sigurimeve përdorin softuerë kompjuterik të krijuar në vend. Ato kanë themeluar Shoqatën e Sigurimeve të Kosovës (SHSK).

### **Operatorët e Transferimit të Parave**

Remitancat e brendshme përbejnë një përqindje të lartë të të ardhurave kombëtare, e cila është përlllogaritur të jetë shumë më tepër se 500 milionë € në vit. Ashtu si edhe në shumë vende, sasia, shpërndarja dhe topologjia e biznesit të transferimit të parave ende nuk është plotësisht e qartë. Janë zhvilluar disa kërkime në këtë sektor<sup>3</sup>, të cilat tregojnë se gati 35% e remitancave dërgohen në saje të operatorëve të transferimit të parave. Pjesa tjetër rreth 50 % e remitancave dërgohen në rrugë joformale, dhe pjesa tjetër nëpërmjet bankave dhe agjencive të udhëtimit. Institucionet mikrofinanciare besojnë së një pjesë a madhe e parave të përdorura për shlyerje të mikrokredive vjen nga remitancat e emigranteve. Zyra e Bankës Botërore në Prishtinë është duke mbështetur një hetim preliminar në disa aspekte të çështjeve të migrimit në lidhje me remitancat.

### **Institucione të tjera financiare**

Për momentin janë shtatë institucione financiare jobankare që veprojnë në Kosovë. Institucionet financiare jobankare ofrojnë një sërë shërbimesh financiare. Veprimtaritë e tyre variojnë nga huadhënia deri te qiratë operacionale dhe financiare.

Gjithashtu në Kosovë veprojnë 21 zyra të këmbimit valutor. Këto institucione u mundësojnë klientëve të këmbëjnë një monedhë për një tjetër. Ato gjithashtu të ngarkojnë me pagesën e një takse për shërbimin e këmbimit valutor.

### **AMBIENTI LIGJOR**

Korniza ligjore e punës në Kosovë është ndërtuar nga rregullore të nxjerra prej Misionit të Përkohshëm të Administratës së Shteteve të Bashkuara në Kosovë

---

<sup>3</sup> *Determinants of Remittances: The Case of Kosovo* – S. Havolli, CBK, 2008

(UNMIK) i cili administroi Kosovën deri në momentin e shpalljes së pavarësisë në shkurt 2008. Që në atë kohë një sërë rregulloresh të UNMIK-ut janë zëvendësuar nga ligjet e adoptuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Një shembull i tillë është Ligji mbi Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, i cili zëvendësoi Rregulloren 2006/47 të UNMIK-ut mbi Autoritetin Qendror Bankar të Kosovës. Rregulloret e UNMIK-ut mbeten në fuqi deri në momentin kur ato të zëvendësohen apo revokohen.

### **Ligjet dhe Rregulloret Aktuale**

Deri më tani për sa ju përket sistemeve të pagesave, aplikohen këto ligje dhe rregulla:

1. *Ligji nr. 03/L-074 mbi Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës*. Dispozitat e këtij ligji në lidhje me SKP janë përshkruar më lart.
2. *Rregullore e UNMIK 2001/26 mbi Transaksionet e Pagesave*. Kjo është e vetmja rregullore (ligj) që mbulon direkt SKP. Dispozitat e tij përfshijnë: përkufizimin e një urdhër pagese; detyrat e pagesit dhe pranuesit dhe bankave të tyre; rregullat për marrëveshjet ndërbankare; rregullat për transferet e debive; dispozitat mbi detyrimet, dëmtimet dhe dëmshpërblimet; rregullat për përdorim të procedimeve të palëve të treta; dhe dispozitat e veçanta në lidhje me llogaritë bankare në transaksionet e pagesave.
3. *Rregulli Bankar nr XVIII i BQK-së mbi Kliringun dhe Veprimtarinë e Llogarive për Shlyerje*. Ky rregull, i cili daton para adoptimit të euros, qeveris përdorimin e llogarive të shlyerjes të bankave komerciale në BQK, përfshi një klauzole ku konfirmohet finalizimi, pakthyeshmëria dhe pandryshueshmëria e transaksioneve në llogarite të shlyerjes. Ai njeh gjithashtu rastin e veçantë të pagesave prioritare, për të cilat ky rregull kërkon nga BQK t'i dërgojë marrësit llogaritë të shlyerjes në një dëftesë.
4. *Ligji nr. 02/L-23 mbi Shërbimet e Shoqatës së Informacionit*. Ky ligj legjitimon dhe përkufizon fushëveprimin e tregtisë elektronike. Është i bazuar në modelin e ligjeve UNCITRAL mbi transaksionet elektronike. Përkufizimi i “pagesave elektronike” në këtë ligj është kufizuar me pagesa të bëra duke përdorur kartelën “duke inkorporuar një shirit magnetik, mikro-rrjet ose çelës biometrik”.
5. Departamenti i Thesarit i Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave është duke përgatitur një draft të ligjit mbi borxhin. Kjo do të ofrojë bazën ligjore për Qeverinë që të lëshojë letra me vlerë. Pritet që ky ligj të përfundohet dhe miratohet gjatë vitit 2009.
6. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë është duke punuar një ligj mbi nënshkrimet elektronike.

Dihet se të gjitha bashkë, siç thamë më lart nuk janë plotësisht të përshtatshme për të mbajtur një SKP modern, me kosto efektive, efikase të sigurt dhe të integruar. Banka Qendrore synon të bëjë një rishikim të plotë të ambientit ligjor, me qëllim që të

hartojë dhe të nxjerrë ligje të reja apo të rishikuara, të nevojshme për të sjellë SKP të Kosovës në një nivel me praktikat më të mira evropiane dhe ndërkombëtare.

### **Kodet SWIFT**

Ende nuk është njohur ndërkombëtarisht kodi shtetëror dyshifror për Kosovën (ashtu siç e përmban standardi ISO 3166), kjo e bën të pamundur qasjen standarde në sistemin SWIFT të institucioneve financiare kombëtare. Për momentin bankat që veprojnë në Kosovë duhet të marrin qasjen në SWIFT në saje marrëveshesh nën juridiksionin e një institucioni tjetër. Shpresohet se me pranimin e Kosovës si anëtare në institucionet ndërkombëtare financiare do të zgjidhet ky problem.

## **INSTRUMENTET E PAGESAVE**

### **Keshi**

Monedha e përdorur në Kosovë është euro. BQK-ja është e obliguar me Ligjin për Bankën Qendrore “*të sigurojë furnizimin e duhur me monedha dhe kartëmonedha për shlyerjen e transaksioneve në para*”, gjë të cilën e bën duke ofruar tërheqje të keshit dhe lehtësira në depozita për konsumatorët e saj, kryesisht banka dhe duke transportuar monedha dhe kartëmonedha në dhe nga eurozona. Ekziston një tepriçë e përgjithshme e keshit, sidomos në verë dhe në sezonin e pushimeve të fundvitit kur Kosova vizitohet nga emigrantet të cilët sjellin me vete edhe para. Si rezultat BQK eksporton më shumë para sesa që importon. Kërkesa kryesore për importim të parasë është në formën e kartëmonedhave me vlerë të vogël, zakonisht për përdorim në ATM, mbasi këto kartëmonedha vjetrohen shumë shpejt.

Sistemi i pagesave në Kosovë karakterizohet nga mbështetja e vazhdueshme në paratë e popullatës. Me përjashtim të pagesave Kos-Giro (të cilat në çdo rast zakonisht paguhen në para), shumica e pagesave ndërbankare të realizuara përmes Sistemit Elektronik të Kliringut Ndërbankar (SEKN) iniciohen nga Qeveria apo entitetet tregtare.

### **Çeqet**

Çeqet nuk përdoren si instrumente për pagesa ndërbankare. Gjithsesi një sërë bankash lëshojnë të ashtuquajturat “çeqe” të cilat përdoren vetëm në baze ndërbankare. Për shembull, kreditë mikrofinanciare zakonisht lëshohen në saje të çeqeve të tilla. Edhe pse përmenden në ligjin e Bankës Qendrore, nuk ka legjislacion të veçantë që mbulon instrumentet e çeqeve/e tregtueshme, dhe nuk ka ndonjë qellim apo nevojë aktuale për të nxjerrë në treg çeqet ndërbankare.

### **Instrumentet Elektronike**

Përveç kartelave (shih më poshtë), për momentin janë në përdorim katër instrumente elektronike pagesash. Për më tepër, një instrument i pestë (debiti direkt) është duke u

testuar nga një numër i vogël institucionesh. Të gjitha këto instrumente mbulohen nga SEKN. Një përshkrim i tyre është dhënë në paragrafët më poshtë.

### **Pagesat Prioritare**

Këto janë pagesa që mund të pranohen në çdo kohë gjatë operimit të SEKN dhe të cilat duhet të shlyhen (klerohen) menjëherë nga SEKN në baze bruto, si dhe brenda 15 minutash mbas pranimit të shumës.

Ato mund të jenë pagesa individuale ose me shumicë (shih më poshtë). Pagesat prioritare dërgohen në llogaritë e shlyerjeve të bankave komerciale mbasi fillon kliringu i radhës që pason pranimin dhe kliringun, sepse nuk ka ndërfaqe plotësisht automatike, elektronike ndërmjet SEKN dhe sistemit themelor bankar të BQK-së. Procesi i vonuar i shlyerjes për pagesat prioritare përfaqëson një element si të shlyerjeve edhe të rrezikut të sistemit edhe pse për momentin niveli i lartë i likuiditetit në ekonomi redukton nivelin aktual të rrezikut.

Vëllimi i pagesave prioritare është i ulët por si vlerë ato përbejnë një përqindje domethënëse. Zakonisht ato janë pagesa komerciale urgjente, dhe mund të konsiderohen si analoge të pagesave me vlera të mëdha, sipas përkufizimit të BIS/CPSS.

### **Pagesat Individuale**

Ashtu si tregon vetë emri, këto janë transfertat kreditore teke të cilat zakonisht iniciohen në degën e një banke ku paguesi mbush një fletë urdhërpaguese e cila me vonë dërgohet në sistemin themelor bankar të bankës dhe për pasojë transmetohet në SEKN për klerim. Paguesi ose paguan në kesh ose autorizon që paratë të tërhiqen nga llogaria e tij/saj bankare. Ky instrument është përgjithësisht analog me transferimin e kredive, ashtu si është përkufizuar nga BIS/CPSS.

### **Pagesat me Shumice**

Këto mund të përdoren për pagesat *një-për-shumë* (për shembull pagesat e rrogave) ose *shumë-për-një* (të cilat kryesisht përdoren për konsolidimin e taksave qeveritare dhe të ardhurave doganore para se t'i përcillen BQK-së nga bankat komerciale). Gjatë çdo seance të kliringut, SEKN ndan pagesat një-për-shumë, dhe konsolidon pagesat shumë-për-një, në pagesa individuale të cilat klerohen më pas. Pagesat me shumicë, thuajse të gjitha bëhen nga, ose për, organizatat qeveritare. BQK dëshiron të inkurajojë sektorin privat t'i përdor më shumë këto lloje pagesash, për shembull për pagesën e rrogave.

## Kos-Giro

Ky mjet është prezantuar në vitin 2005 si një mënyrë me të cilën konsumatorët mund të paguajnë faturat. Në saje të këtij sistemi, faturues të tillë si kompanitë e shërbimeve komunale kanë një forme pagese standarde në fund të faturës që ata i dërgojnë konsumatorit. Ky format pagese përmban detajet e pagesës në një barkod i cili skanohet kur konsumatori paraqet faturën për pagese në secilën banke. Detajet e pagesës merren dhe përmes sistemit themelor bankar të bankës komerciale përcillen në SEKN, dhe paguesi ose paguan me para në dorë ose i zbriten nga llogaria e tij bankare (nëse paguesi ka një llogari bankare dhe fatura paraqitet në atë bankë që ai ka llogarinë). Kjo është një tjetër formë e transfertës kreditore individuale. Edhe pse kjo ekziston konsumatori nuk e para-autorizon bankën të zbresë nga llogaria e tij shumën për shlyerjen e pagesave për fatura të tilla që përsëriten. Përdorimi i Kos-Giro ka treguar një rritje të vazhdueshme që prej fillimit të saj, sidomos me vëllimin mujor të pagesave i cili është rritur më shumë se trefish gjatë vitit 2008. Përdorimi i saj nga konsumatorët e energjisë elektrike (KEK) u dyfishua në periudhën korrik – dhjetor 2008. Pothuajse të gjitha pagesat e doganave, të cilat e adoptuan këtë sistem në qershor 2007, tashmë bëhen me Kos-Giro.

## Debiti Direkt

SEKN kohët e fundit është zgjeruar për të ofruar funksionin e debitit direkt. Kjo është provuar gjatë vitit 2009 fillimisht nga KEK-u.

## Kartelat

Bankat lëshojnë kartelat e tyre (shumë prej të cilave janë Visa dhe/ose MasterCard) dhe veprojnë në rrjetin e tyre të Makinerisë së Sportelit Automatik ATM (automatëve) dhe terminaleve të pikave të shitjeve (POS). Jo të gjitha bankat veprojnë me rrjetin POS. Siç shihet nga të dhënat më poshtë (që tregojnë statistikën relevante për tremujorin e dytë të vitit 2009) përdorimi i kartelave është ende i pakët:

	Nr. instaluar	Nr. i transaksioneve (përmes llogarive vetjake)	Vlera totale e transaksioneve (€)
terminalet POS	4,612	275,380	12,495,847
ATM	282	1,510,123	118,018,411
Numri i kartelave të debitit të lëshuara	302,689	Numri i kartelave të kreditit të lëshuara	20,374

Burimi: BQK

Numri i POS terminaleve të instaluar është paksa çorientues, mbasi shumë pika shitje me pakicë (dyqane) kanë POS terminale nga disa banka. Instalimi i shumë terminaleve në një dyqan është i domosdoshëm pasi nuk ekziston kartela elektronike



kombëtare ndërbankare si dhe mundësia e kliringut të tillë dhe për pasojë asnjë marrëveshje ndërveprimi të rrjetit vendor bankar ndërmjet bankave (duhet pasur parasysh se e njëjta gjë ndodh edhe me ATM-te). Çdo bankë njih transaksionet nga kartela e saj përmes rrjetit të saj dhe i dërgon ato në një qendër procesimi të kartelave jashtë Kosovës. Transaksionet “tek ne” realizohen brenda përbrenda secilës bankë. Mungesa e ndërveprimit apo ndërlidhjes vendore të rrjetit të kartelave në Kosovë shkakton mosefikasitet dhe kosto dhe gjithashtu vepron si konkurrencë në bankat e vogla e sidomos ato vendore.

Transaksionet vendore dhe ndërkombëtare të karteleve shlyhen edhe nëpërmjet rrjeteve ndërkombëtare. Kjo mundëson një sërë sferash të rrezikut.

### **e-Banking**

Shumica e bankave kanë prezantuar e-Banking nëpërmjet të cilës konsumatorët mund të kenë qasje në llogaritë e tyre dhe të bëjnë transaksione nga kompjuteri duke përdorur një ndërfaqe të internetit. Transaksionet e pagesave ndërbankare të iniciuara nëpërmjet e-banking regjistrohen në sistemin themelor bankar të bankës dhe transmetohen në SEKN për klerim. Shërbimet e-banking ende nuk janë gjerësisht të përdorshme, ndoshta kjo ka të bëjë me përdorimin e përgjithshëm të internetit në Kosovë.

### **m-Banking**

Në përgjithësi, për momentin vërehet një interesim i ulët i institucioneve financiare për të zhvilluar shërbimin mobil bankar dhe të pagesave. Megjithatë disa banka po shqyrtojnë mundësinë e prezantimit të shërbimit bankar mobil.

## **KLIRINGU DHE SHLYERJA**

### **Sistemi Elektronik i Kliringut Ndërbankar (SEKN) <sup>4</sup>**

BQK ka në veprim një sistem të vetëm hibrid pagesash të quajtur SEKN i cili kleron të gjitha pagesat prioritare, pagesat individuale, pagesat me shumicë, pagesat Kos-Giro dhe pagesat e debitit direkt. Ky sistem është krijuar në vend. Institucionet ndërkombëtare i kanë ofruar këshillim dhe fonde Autoritetit Bankar të Pagesave të Kosovës (paraardhësi i BQK-së) në disenjimin dhe zhvillimin fillestar të sistemit të pagesave dhe softuerit SEKN. Gjatë vitit 2008 SEKN është rihvilluar për të qenë plotësisht i bazuar në rrjet, gjë e cila ka përmirësuar dukshëm përdorimin dhe funksionimin e tij. Të gjitha bankat komerciale janë pjesëmarrëse në SEKN, mbasi është për BQK-në (vetë dhe në emër të Qeverisë). Drejtorati Ndërbankar i Sistemit të Pagesave të BQK-së udhëheq Komitetin Këshillues të Pagesave Ndërbankare (KKPN) i cili është themeluar për të vendosur rregullat e veprimit, procedurat dhe standardet për SEKN, dhe i cili mbledhet vazhdimisht për të diskutuar çështjet operationale.

<sup>4</sup> Informacion të hollësishëm mbi SEKN mund të gjeni në ueb-faqen e BQK <http://www.bqk-kos.org/english/ICS.htm>

Ekziston një frymë e lartë bashkëpunimi ndërmjet pjesëmarrësve që përdorin SEKN, i cili është pranuar mirë nga të gjitha bankat.

Sistemet themelore bankare të pjesëmarrësve në SEKN janë të lidhura në mënyrë elektronike me SEKN, d.m.th proces i drejtpërdrejtë (PDD) është arritur me të gjitha bankat. Për momentin orët e veprimtarisë janë 8.00 deri 15.30. Një numër pjesëmarrësish kanë kërkuar që orari i veprimtarisë të rishikohet.

Pjesëmarrësit mund të dërgojnë në çdo kohë grumbuj pagesash elektronike në SEKN. Kjo realizohet në sajë të rrjetit ndërbankar i cili përdor linjat e telekomunikacionit të kontraktuara nga kompania publike e telekomunikacionit (PTK). Siguria e rrjetit është përmirësuar dukshëm vitet e fundit. Me përjashtim të pagesave prioritare, të cilat klerohen brenda 15 min, grumbujt e pagesave radhiten në SEKN deri në seancën kleruese të radhës

SEKN përdor formate unike të mesazheve të cilat janë dizajnuar gjatë krijimit të sistemit<sup>5</sup>. Tashmë është sugjeruar që sistemi të rihartohet për të përdorur format standarde të mesazheve ISO 15022 (SWIFT). Ky do të jetë një parakusht për çdo integrim në të ardhmen në sistemet evropiane apo në sistemin vendor të Shlyerjes së Pagesave në Kohë Reale (SHPKR).

Numri dhe vlera e pagesave që përpunon SEKN kanë treguar rritje të vazhdueshme, që të dyja thuajse janë dyfishuar gjate periudhës dhjetor 2007 – dhjetor 2008.

---

<sup>5</sup> Hollësi mbi formatet e mesazheve mund t'i gjeni në <http://www.bqk-kos.org/ICS/Standard file.pdf>

Tabela 1. Transaksionet SEKN, te paraqitura ne numër dhe vlere për periudhën Dhjetor 2007 – Dhjetor 2008

Muaji	Numri i transaksioneve të rregullta	Numri i transaksioneve prioritare	Numri i transaksioneve me shumicë (detaje)	Numri i transaksioneve Kos-Giro (detaje)	Numri total	Shuma e transaksioneve të rregullta	Shuma e transaksioneve prioritare	Shuma e transaksioneve me shumicë	Shuma e transaksioneve Kos-Giro	Shuma Totale	Av	
											Nr	
Dhjetor 07	43,327	448	60,300	13,951	118,026	184,611,976	21,756,101	21,327,231	50,594,153	278,289,463	5,365	
Janar 08	21,200	309	119,199	10,327	151,035	115,061,989	28,510,124	27,619,204	31,114,521	202,305,839	6,865	
Shkurt 08	27,259	324	59,569	11,854	99,006	98,160,998	17,467,070	14,958,601	36,314,887	166,901,557	4,500	
Mars 08	31,017	370	67,438	13,788	112,613	116,885,638	18,055,424	13,511,789	39,707,902	188,160,754	5,119	
Prill 08	34,834	433	152,070	15,279	202,616	108,878,562	42,859,695	45,585,040	46,360,599	243,683,897	9,210	
Maj 08	32,787	500	134,510	16,108	183,905	129,496,819	44,395,129	17,893,444	55,869,202	247,654,596	8,359	
Qershor 08	30,198	482	181,487	17,130	229,297	152,650,896	20,491,070	19,191,346	52,347,263	244,680,576	10,423	
Korrik 08	31,318	618	279,897	17,602	329,435	144,951,857	30,763,348	45,850,510	56,922,634	278,488,351	14,974	
Gusht 08	24,661	503	203,246	24,306	252,716	126,950,290	21,604,815	19,467,863	56,143,824	224,166,793	11,487	
Shtator 08	30,212	550	194,649	28,511	253,922	161,286,935	42,230,165	21,372,578	55,035,578	279,925,256	11,542	
Tetor 08	32,554	613	279,561	31,654	344,382	182,654,957	29,282,289	53,363,286	57,707,380	323,007,913	15,654	
Nëntor 08	30,489	524	183,514	24,776	239,303	144,832,324	28,798,911	20,222,043	51,666,565	245,519,845	10,877	
Dhjetor 08	48,008	911	242,788	35,166	326,873	367,653,703	44,869,107	36,706,525	71,697,386	520,926,721	14,858	
<b>Totali 08</b>	<b>374,537</b>	<b>6,137</b>	<b>2,097,928</b>	<b>246,501</b>	<b>2,725,103</b>	<b>1,849,464,973</b>	<b>369,327,151</b>	<b>335,742,234</b>	<b>610,887,745</b>	<b>3,165,422,105</b>	<b>10,322</b>	

Burimi: BQK

## **Kliringu**

BQK vë në funksion katër seanca kliringu të SEKN në ditë për të gjitha llojet e pagesave përveç pagesave prioritare, një në orën 8.00 (me vlerat e të dhënave të një dite më parë), në orën 10.30, në 13.30 dhe në orën 15.00. Çmimi për transaksion ndryshon në saje të llojit të instrumentit të pagesës dhe seancës së kliringut: çmimet janë më të larta për seancën e orës 8.00 dhe më të ulëtat për seancën e orës 10.30, duke u rritur përsëri gjatë seancave të më vonshme. Pagesat prioritare klerohen një nga një në bazë bruto, jo me pak se 15 min pas pranimit të tyre, nga ora 8.00 deri në përfundim të orarit në 15.30.

## **Shlyerjet**

Shlyerja arrihet duke futur të dhënat neto të bilanceve nga SEKN në sistemin themelor bankar të BQK-së. Shlyerja realizohet mbi llogarite e veçanta të pjesëmarrësve të mbajtura në sistemin themelor bankar nuk ka llogari të veçanta të shlyerjeve. Procesi i shlyerjes është pjesërisht automatik dhe përfshin edhe ndërhyrjen manuale si dhe koordinimin gjatë ditës ndërmjet Drejtoratit Ndërbankar të Sistemit të Pagesave dhe stafit tjetër të BQK-së. Për të realizuar transferim të plotë elektronik të shlyerjeve nga SEKN nevojitet modifikim i sistemit themelor bankar të BQK-së, i cili pritet të ndodh gjatë 2009.

Drejtorati Ndërbankar i Sistemit të Pagesave monitorin procesin e shlyerjeve, në veçanti për të ruajtur nivelin minimal të likuidimit të rezervave. Niveli i detyrueshëm i rezervave për çdo bankë është 10% e bazës së caktuar të depozitave të çdo banke, prej të cilave të paktën gjysmat (5%) duhet të mbeten gjithmonë në BQK; për pasojë bankat lejohen të zbresin në llogaritë e tyre vetjake deri në shumën ekuivalente të këtij 5%-shi gjatë shlyerjes – por jo më poshtë. Nëse ka mungese bankës i kërkohet të gjejë para të mjaftueshme për të rimbushur llogarinë e saj vetjake. Nuk ka procedura për të kthyer mbrapa pagesat në rast se banka nuk ka mundësi të shlyejë. Një tjetër zonë rreziku ka të bëjë me shlyerjen e pagesave prioritare. Këto nuk shlyhen menjëherë për t'u kliruar, por shlyerja e tyre realizohet në bazë (bruto) individuale në kohën e shlyerjes së pozicioneve multilaterale nga seanca e ardhshme e shlyerjeve mbasi të jenë pranuar dhe kliruar. Në të dyja fushat, për momentin, niveli i lartë i likuiditetit në ekonomi dhe vëllimi dhe vlera e limituar e pagesave ulin nivelin aktual të rrezikut.

## **TRANSAKSIONET E QEVERISË**

### **Pagesat e Qeverisë**

Të gjitha pagesat e Qeverisë gjenerohen nga një sistem i veçantë informativ për menaxhimin e financave i instaluar në Departamentin e Thesarit të Mistrisë së Ekonomisë dhe Financave. Kryesisht ky sistem mbledh nga ministritë të gjitha pagesat që janë realizuar me sukses nëpërmjet proceseve të nevojshme të autorizimit dhe i shndërron ato në mjete të transferueshme të cilat barten fizikisht në BQK si të hyra për sistemin themelor bankar të BQK-së, nga i cili dërgohen individualisht në llogarinë e destinuar të Thesarit. Prej sistemit bankar themelor ato transferohen në mënyrë

elektronike në SEKN, ku përpunohen për klirim. Numri mesatar ditor i pagesave është rreth 500. Një numër i vogël i urdhërpagesave qeveritare i dërgohen BQK-së në letër, ku në mënyrë manuale hidhen në sistemin themelor bankar të BQK-së, dhe përpunohen më tej siç e përshkruam më lart. Këtu përfshihen pagesat e shërbyesve civile dhe pensionet bazë, të cilat përpunohen nëpërmjet sistemit themelor bankar të BQK-së dhe SEKN si shuma totale të veçanta që ju dërgohen të paguarve në bankat e tyre. Detajet individuale të pagave dhe pensioneve dërgohen direkt në bankën e të paguarit nga institucioni qeveritar përkatës.

Disa banka kanë shprehur pakënaqësinë se pagesat e Qeverisë dërgohen në SEKN vonë në mesditë, gjë e cila është e pafavorshme për menaxhimin e tyre të likuidimeve. Qëllimi i BQK është të punojë me Thesarin për të mundësuar dërgimin e pagesave në fillim të ditës. Kjo do të ndihmonte në sigurimin e likuiditetit të duhur në përgjithësi në sistemin e pagesave, dhe do të ishte shumë më e rëndësishme sesa prezantimi i një sistemi të plotë të SHPKR nga ana e BQK-së.

Ekziston një lidhje telekomunikacioni ndërmjet Thesarit dhe BQK-së, por për momentin kjo përdoret vetëm për t'i transmetuar Thesarit raportet mbi gjendjen.

### **Të hyrat nga taksat**

Administrata Tatimore mbledh një sërë taksash, me cikle pagesash mujore dhe tremujore. Taksapaguesit paguajnë në bazë vetëvlerësimi duke përdorur formularë të para printuar të cilët gjenden si në zyrën e Administratës Tatimore edhe në bankat komerciale. Pagesat bëhen në bankat komerciale, të cilat pranojnë informacionin e nevojshëm nga formularët mbi detyrimin e mbetur të borxhit dhe ja dërgojnë pagesat BQK-së në formë të pagesave me shumicë për t'u përpunuar nga sistemi SEKN. Numri i përgjithshëm i faturave të taksave të ardhura nga një bankë e vetme për çdo seancë klirimi dërgohet nga SEKN në sistemin themelor bankar të BQK-së, ndërsa detajet e pagesave individuale mbeten të regjistruara vetëm në SEKN. Për pasojë përveç gjendjes së llogarisë të nxjerra nga sistemi themelor bankar i BQK-së, Administratës Tatimore i nevojiten gjithashtu informacione të detajuara nga SEKN. Gjendjet e llogarive i dërgohen Thesarit nëpërmjet lidhjes së lartpërmendur të telekomunikacionit ndërmjet BQK-së dhe Thesarit, gjithashtu në saje të lidhjeve të tij me SEKN Thesari merr informacion të detajuar nga SEKN. I gjithë informacioni relevant i marrë nga Thesari i dërgohet Administratës Tatimore. Për më tepër, banka i dërgon Administratës Tatimore një kopje të informacionit mbi detyrimin e mbetur të borxhit.

Nga perspektiva e Administratës Tatimore, për momentin ky sistem po funksionon mirë. Sa i përket të ardhmes, Administrata Tatimore po punon që t'u dërgojë taksapaguesve direkt faturat mbi detyrimin e mbetur të borxhit, mundësisht në mënyrë elektronike, dhe mendon ta zbatojë këtë si projekt pilot në vitin 2009. Gjithashtu ka filluar plani për të zbatuar mbushjen-e (elektronike) të detyrimit të borxhit. Administrata Tatimore planifikon që të punojë më ngushtë me BQK-në për të përmirësuar efikasitetin e përgjithshëm të procesit të mbledhjes së taksave.

### **Të hyrat doganore**

Të ardhurat e mbledhura nga doganat vijnë nga detyrimet e importit dhe taksat e akcizës (indirekte) të karburantit dhe alkoolit, dhe përbejnë 70% të të hyrave shtetërore. Të hyrat kanë treguar një rritje të vazhdueshme dhe tashmë sillen rreth 800 në ditë (205,000 në vit)<sup>6</sup>. Doganat veprojnë me dymbëdhjetë sportele pagesash, dhe gjithashtu mbledhin akcizat direkt nga prodhuesit e pijeve alkoolike në bazë mujore.

Asnjë pagesë nuk pranohet në para; të gjitha pagesat bëhen nëpërmjet bankave komerciale. Mbi 90% e të gjitha pagesave bëhen me Kos-Giro, duke përdorur formate pagesash të cilat printohen direkt nga sistemi qendror kompjuterik i doganave në sportelet ku mblidhen të ardhurat. Mallrat e importit mbahen në sportelet doganore të pagesave të pashlyera. Bankat kanë zyrat e tyre në pikat kufitare dhe mbledhin një përqindje të madhe të pagesave Kos-Giro nëpërmjet këtyre zyrave. Pjesa e mbetur e pagesave Kos-Giro realizohet nga importuesit në zyra të tjera bankare. Për më tepër një sërë bankash kanë terminale POS në sportelet doganore, disa prej të cilave posedojnë lexues të barkodit të cilët përdoren për të skanuar të dhënat nga faturat e Kos-Giro. Përmes terminaleve POS realizohen vetëm 2% e pagesave.

Bankat komerciale konsolidojnë pagesat doganore në pagesa me shumicë për t'i futur në sistemin SEKN. Po në të njëjtën mënyrë ato përpunohen më tej si të hyra nga taksat ashtu siç e përmendëm më lart doganat marrin informacion si nga bankat komerciale edhe nga BQK, i cili duhet të korrespondojnë dhe më pas i dërgojnë raportin e tyre Thesarit.

Doganat do të donin të operonin një kartelë për qasje kombëtare duke përdorur për të gjitha pagesat në zyrat doganore një terminal POS të vetëm, pavarësisht nga banka në të cilën paguesi e ka llogarinë.

### **Portali e-Qeverisja**

BQK është anëtare e një grupi pune i cili është duke krijuar *Strategjinë e Qeverisjes Elektronike 2009-2015* për Qeverinë nën udhëheqjen e Departamentit të Teknologjisë Informative të Ministrisë së Administratës Publike. Ndër shërbimet e parashikuara në këtë strategji është edhe një “portal-e” nëpërmjet të cilit qytetarët, bizneset dhe institucionet do të jenë në gjendje t'i bëjnë të gjitha pagesat ndaj Qeverisë në mënyrë elektronike.

Për sa ju përket këtyre pagesave, do të ishte me rëndësi të vendosej/zgjidhej në një fazë më të hershme se si do të realizohen ato, çfarë instrumente do të ishin të pranueshme për të bërë pagesa ndaj Qeverisë, dhe se si të ndërthuren ndërfaqet e nevojshme me sistemin e pagesave

### **LET RAT ME VLERË**

Për momentin as Qeveria as BQK-ja nuk lëshojnë letra me vlerë. Sipas kornizës ekzistuese ligjore, Qeverisë nuk i lejohet të hyjë në borxh dhe për pasojë për momentin

<sup>6</sup> Source: Kosovo Customs Service, February 2009

është në një situatë të vazhdueshme kreditimi. 95% të aseteve të Qeverisë, investohen përmes BQK-së si letra me vlerë afatshkurtër të Qeverisë në vendet e UE dhe si depozita me afat në banka të huaja me kapital të lartë. Thesari dëshiron me çdo kusht të zhvillojë tregjet financiare vendore, ndaj edhe po planifikon të vërë në qarkullim instrumente të borxhit qeveritar, duke filluar nga bonot e thesarit afatshkurtër. Thesari dëshiron t'i vërë ato në qarkullim në një të ardhme të afërt, me qëllimin fillestar të të fituarit eksperiencë dhe inkurajimin e zhvillimit të tregut. Është duke u hartuar një draftligj mbi borxhin, i cili do të ofrojë sanksionet ligjore për letrat me vlerë të Qeverisë. Dihet se do të nevojiten përpjekje të shumta për t'u përgatitur për hedhjen në treg të letrave me vlerë të Qeverisë, dhe jo më pak për edukimin e tregut dhe në veçanti të bankave. Është parashikuar që BQK-ja të veprojë si agjent fiskal i Qeverisë për shitjen dhe kujdestarinë ndaj instrumenteve qeveritare të borxhit.

Bazuar në zhvillimet e deri tanishme do të ishte e këshillueshme për BQK-në që të planifikojë të vërë në zbatim një sistem të shlyerjes dhe depozitimit për tregtimin e letrave me vlerë, bazuar në paketën CSD, gjatë një periudhe afatshkurtër ose afatmesme. Kjo do të integrohet në një sistem SHPKR i cili do të realizojë kliringun dhe shlyerjen e pagesave prioritare nga SEKN, ashtu si shtjellohet më tej në pjesën IV ("Shtyllat e Vizionit të Sistemit të Pagesave"). Gjithsesi në mënyrë që të parandalohet konfuzioni dhe për pasojë zbatimi jo i saktë i këtyre projekteve, BQK do të ndërmarrë hapa për të siguruar një kuptimshmëri të qartë dhe përcaktimin e roleve dhe përgjegjësisive përkatëse të Thesarit dhe BQK-së, në letrat me vlerë të Qeverisë dhe sektorin e tregjeve kapitale.

Duhet gjithashtu të marrë parasysh se për momentin nuk ka rregullator apo mbikëqyrës të tregut të letrave me vlerë, sepse ky treg për momentin nuk ekziston.

### III. PËRKUFIZIMI I STRATEGJISË SË SISTEMIT TË PAGESAVE

**Kjo pjesë sqaron modelin e përgatitur nga BQK-ja për krijimin e SKP dhe reflekton nevojën e vendit në tërësi për këtë sistem dhe përgjegjësitë ndaj tij të grupeve të ndryshme të interesit.**

BQK është duke adoptuar një qasje strategjike për reformën mbi sistemin e pagesave në Kosovë. Eksperienca e disa vendeve të tjera ka treguar se mungesa e qasjes së koordinuar ndaj çështjeve të sistemit të pagesave jo vetëm që dëmton burimet e projekteve individuale, por dëmton gjithashtu infrastrukturën e përgjithshme financiare dhe së fundi ekonominë në tërësi. Pa një strategji të SKP, ekziston rreziku që e ardhmja e sistemit të pagesave në Kosovë të jetë padyshim rezultat i përpjekjeve individuale të grupeve të interesit të cilët do të përpiqen të përmirësojnë sistemet e tyre duke pasur parasysh interesin e përgjithshëm kombëtar.

Arkitektura e një SKP duhet të konsiderohet si një element i rëndësishëm për sigurinë dhe stabilitetin e sistemit financiar në përgjithësi. Konsensusi është shumë i domosdoshëm për një qasje strategjike dhe bashkëpunimi. Kjo do të thotë se duhet të bëhet një vëzhgim i tërësishëm i të gjitha aspekteve mbi nevojat e sistemit kombëtar të pagesave, në mënyrë që ato të përmbushen si duhet dhe me kosto sa më efektive. Bashkëpunimi dhe pjesëmarrja aktive e të gjitha grupeve të interesit është shumë e dëshirueshme për shkak të kompleksitetit të ndryshimeve të nevojshme. Këto ndryshime do të përfshijnë rezultate në lidhje me ofruesit e shërbimeve, përdoruesve, teknologjitë, çështjet ligjore dhe rregullative si dhe kontributin nga disa disiplina profesionale. Një qasje bashkëpunimi e strukturuar mirë do të sillte bashkim forcash, do të stimulonte të mësuarit dhe do të ofronte bazën për përfitim më optimal në saje të bashkëpunimit dhe marrëveshjes. Së fundi qasja strategjike do të mund të adresojë të gjitha çështjet kritike që ekzistojnë në marrëveshjet aktuale të pagesave.

BQK po merr rolin drejtues në formulimin dhe zbatimin e strategjisë për modernizimin e sistemit të pagesave. BQK-ja do të veprojë në interes të sistemit në tërësi sepse posedon mandatin ligjor për të vepruar në interes të përbashkët, duke synuar të rritë besimin e pjesëmarrësve si agjent neutral. Si agjent neutral, BQK ka me pak te ngjare te nxisë çështjen e konkurrencës e cila mund të dobësojë progresin dhe është në gjendje të mbështesë me fuqishëm krijimin e një vizioni mirëkuptimi për SKP në të ardhmen.

Qëllimi dhe sfidat për zhvillimin dhe krijimin e një strategjie për modernizimin me sukses të sistemeve të pagesave nuk duhet nënvlerësuar. Ky do të jetë një proces i ri dhe projektet që do të hartohen dhe realizohen nën ombrellën e strategjisë në përgjithësi do të sjellin sfida të reja për të gjitha palët e përfshira. Rreziqet kryesore janë:

- (i) sistemi i krijuar nuk mund të përdoret;
- (ii) ndryshimet që do të bëhen në sistem nuk do të përmbushin nevojat e të gjithë përdoruesve: dhe




(iii) sistemet do të kenë kosto të lartë dhe do të jenë të papërballeshëm financiarisht.

Bashkëpunimi dhe bashkëveprimi janë mënyrat e vetme për të minimizuar këto rreziqe. Në mënyrë që të kemi një bashkëveprim efikas është e rëndësishme të sigurohemi se kemi burimet e duhura njerëzore si në numër dhe ekspertizë dhe se ato i ofrohen programit zhvillimor nga të gjitha grupet e interesit të përfshira në të.

## **ROLI I NJË SISTEMI KOMBËTAR PAGESASH**

Është pranuar thujtë nga të gjithë se një SKP përbëhet nga një grup i caktuar institucionesh dhe një sërë instrumentesh dhe procedurash, të përdorura për të lehtësuar qarkullimin e parave brenda dhe jashtë vendit. Ekonomia e çdo vendi mund të shikohet si një sërë shtresash në një piramide të përmbytur, në të cilën secila shtresë mbahet nga shtresat nën të, siç tregohet në diagramin më poshtë.



Shtresa më e gjerë e piramidës përfaqëson ekonominë reale dhe tregjet financiare, d.m.th blerjen dhe shitjen e mallrave dhe shërbimeve kudo brenda vendit. Ajo mbështetet nga sistemi bankar vendor – niveli tjetër i piramidës – ofron shërbime të pagesave për të gjithë sektorët e ekonomisë.<sup>7</sup> Niveli i tretë përbëhet nga një numër i kufizuar i sistemeve ndërbankare të transferimit të shumës përmes të cilit përpunohen pagesat dhe transaksionet e tjera financiare.

Shlyerja përfundimtare e transferimit të fondeve realizohet përmes llogarive të cilat institucionet e aprovuara i mbajnë në Bankën Qendrore, roli boshtor i kësaj është vital për funksionimin e ekonomisë në tërësi.

<sup>7</sup> Duke përfshirë sektorin individual, tregun me pakicë, sektorin industrial dhe komerciale, atë financiar, qeveritar dhe ndërkombëtar.

Për pasojë SKP është komponent bazë i sistemit të gjerë financiar dhe mund të shihet si infrastruktura e cila i ofron ekonomisë kanalet apo rrjetet për përpunim të pagesave që rezultojnë nga lloje të ndryshme të transaksioneve ekonomike që realizohen në baze ditore – ose thënë ndryshe, mekanizmi lubrifikues i domosdoshëm për motorin e ekonomisë.

Një SKP që funksionon si duhet kërkon një balancë delikat midis konkurrencës së tregut, bashkëveprimit dhe konsideratës për mallrat publike. Në një ambient të maturuar, bankat dhe ofrues të tjerë të shërbimeve të pagesave duhet të konkurrojnë për biznesin e pagesave dhe konsumatorët, ndërkohë që arrijnë përfitime dhe efikasitetin që cili buron nga ndarja e infrastrukturës jokonkurruese. Në interes të vendit, është e domosdoshme të arrihet një nivel i lartë ekonomik dhe infrastruktura e shërbimit kombëtar të pagesave të lejojë sa më shumë pjesëmarrës që të jetë e mundur t'i ofrojnë shërbimin e tyre publikut.

## **QËLLIMI DHE KOMPONENTËT E NJË SKP**

Duke pasur parasysh pikat më lart, është e qartë se një SKP gjithëpërfshirës përbëhet jo vetëm nga mekanizmat e transferimit të fondeve – organizatat që përpunojnë pagesat, rrjetet e komunikimit dhe sistemet kompjuterike – por duhet të përfshijë të gjitha siç vijon:

- Institucione që ofrojnë ndërmjetësim financiar;
- Një kornizë pune ligjore dhe statutore;
- Rregulla, rregullore dhe marrëveshje;
- Instrumente të përshtatshme pagesash;
- Shqyrtim sistemesh dhe procedurash;
- Një infrastrukturë teknologjike me kosto efektive;
- Mekanizma të kliringut dhe shlyerjes të cilat balancojnë si duhet rrezikun dhe nevojat efikase;
- Një sërë ofruesish të shërbimit të pagesave të zgjedhur me kujdes si dhe produkte me kosto të pranueshme që përmbushin nevojat e tregut; dhe
- Një kornizë pune të përshtatshme për mbikëqyrjen.

## **KORNIZA MBI KONCEPTIMIN E PUNËS PËR HARTIMIN E SKP**

Zakonisht në çdo ekonomi, me kalimin e kohës, shërbimet e pagesave kanë evoluar në rritje, të shtyrë ose nga nevoja për të përballuar sfidat që janë shfaqur, ose për të përfituar nga mundësitë për përmirësim të identifikuar qartë. Për të parandaluar vazhdimësinë e kësaj qasje ad-hoc ndaj hartimit të SKP, disa vende kanë stopuar dhe kanë filluar një qasje strategjike, të shtyrë nga nevojat aktuale të komuniteteve të biznesit dhe bankave për të identifikuar dhe zbatuar një sërë fazash ndryshimi – bazuar në marrëveshjet midis grupeve të interesit – duke u siguruar se po realizojnë një vizion të qartë afatmesëm të SKP. Një zbatim i duhur dhe pa telashe i SKP mund të arrihet me

anë të hartimit të një vizioni i cili merr parasysh të gjitha masat e nevojshme për sa i përket qëllimit dhe objektivave, tipareve primare, faktorëve kritikë të suksesit, parimeve themelore dhe strategjive.

### Qëllimet dhe Objektivat

Nuk ka mosmarrëveshje mbi faktin se qëllimi kryesor i SKP është të mundësojë qarkullimin e parave.<sup>8</sup> Ky qëllim thekson faktin se SKP është një lubrifikues i aktivitetit ekonomik. Ai ofron rrjetet për të ndikuar tek pagesat, vendore dhe ndërkombëtare. Zakonisht nuk ka mosmarrëveshje as për objektivat e SKP. Ekzistojnë tri objektiva të mëdha të SKP në Kosovë:

- Të ofrojë mekanizma efikas për shkëmbimin e parave ndërmjet palëve të dakorduara;
- Të sigurojë finalizimin dhe pandryshueshmërinë (d.m.th sigurinë) si të pagesave edhe të shlyerjes; dhe
- Të mundësojë menaxhimin, reduktimin, dhe përmbajtjen e rrezikut të sistemit dhe rreziqeve të tjera që kanë të bëjnë me pagesat.

### Tiparet Themelore

Tiparet themelore të SKP duhet të diskutohen në mënyrë më të detajuar dhe të arrihet marrëveshje për to ndërmjet të gjitha grupeve të interesit mbasi ato do të përbëjnë gamën e plotë të politikave, karakteristikat operacionale dhe teknike që do të formojnë të ardhmen. Ato duhet të përmbajnë të paktën siç vijon:

- Shlyerja e obligacioneve ndërbankare vendore të realizohet brenda ditës;
- Konkurrencë e mirë ndërmjet ofruesve të shërbimit të pagesave ndaj konsumatorëve;
- Qasje e lehtë në SKP;
- Kosto efikase e SKP;
- SKP i sigurt dhe me teknologji të mirë;
- Me kohë SKP do të hartohet në mënyrë të tillë që të përfshijë nën-sistemet e duhura për shitjet me pakicë, me shumicë, shkëmbimin valutor, tregjet e artikujve për përdorim të gjerë, tregun e kapitalit si dhe tregun e transaksionit të parave;
- Publiku të jetë i informuar mbi tiparet e SKP;
- SKP mbështet veprimet elektronike të DkP dhe PkP;
- Të jetë një SKP i pranuar ndërkombëtarisht;
- Vonesat në kohë për shlyerjen e pagesave që rezultojnë nga tregtimi i transaksioneve të jenë nëpërputhje me praktikat ndërkombëtare;

<sup>8</sup> Këtu fjala “para” është përdorur në kuptim të gjerë dhe përfshin të gjitha format e pagesave, si me kesh, kartelë, pagesat elektronike, etj.

- SKP duhet të shfrytëzojë në maksimum likuiditetin në dispozicion;
- Komuniteti ndërkombëtar të vlerësojë efikasitetin e SKP.

### **Faktorët Kritikë të Suksesit**

Suksesi i SKP do të matet në saje të arritjes së një sërë faktorëve përfshirë ato të ilustruara më poshtë;

- Matës - adekuate - dhe të provuar si efikase- të kontrollit të rrezikut;
- Pathyeshmëria e transaksioneve të shlyera;
- Sinkronizim i dërgesës dhe pagesës;
- Likuiditet i mjaftueshëm në baza të qëndrueshme;
- Siguri dhe konfidencialitet;
- Një bazë e duhur ligjore;
- Zbatim të rregullave, rregulloreve dhe procedurave kombëtare;
- Parandalim i shkeljeve dhe vendosja dhe funksionimi i masave për detektimin e tyre;
- Varietet i instrumenteve të pagesave për të përmbushur nevojat e të gjithë komunitetit;
- Politika e çmimeve të jetë në përputhje me objektivat e përgjithshme të SKP;
- Shërbim për të gjithë popullin e Kosovës.

### **Tiparet Themelore**

Një çështje jetike për hartimin dhe zbatimin e SKP është arritja e konsensusit për të gjitha parimet themelore. *Parimet Bazë për Sistemet e Pagesave Sistematikisht të Rëndësishme*, publikuar në 2001 nga Komiteti për Sistemet e Shlyerjes dhe Pagesave (KSSHP), *Rekomandimet për Sistemet e Shlyerjes së Letrave me Vlerë* KSSHP-IOSCO, 2001<sup>9</sup>, dhe *Parimet e Përgjithshme për Shërbimet e Remitancave Ndërkombëtare*, KSSHP - Banka Botërore, 2007 janë shembuj të parimeve të tilla.<sup>10</sup>

Për më tepër, mbasi SKP mbulon të gjitha sistemet e pagesave, gama e parimeve themelore të tij duhet të mbulojë gjithashtu të gjitha nën-sistemet përfshirë siç vijon:

- Pajisja me shërbimin e SKP nuk është sfera ekskluzive e bankave;
- Evolimi i infrastrukturës së SKP është një përgjegjësi e përbashkët;
- Pjesëmarrësit janë përgjegjës për rreziqet që ata paraqesin në SKP;
- Mbahet një bilanc ndërmjet reduktimit të rrezikut dhe kostos;

<sup>9</sup> IOSCO është Organizata Ndërkombëtare e Komisioneve të Letrave me Vlerë (ONKLV)

<sup>10</sup> Të gjitha këto dokumente mund t'i gjeni në [www.bis.org](http://www.bis.org) (KSSHP).

- Reagimi i BQK-së ndaj çdo problemi në SKP do të jetë në interes të sistemit, dhe jo të pjesëmarrësve individuale;
- Nevojitet mbikëqyrja e duhur për të garantuar sigurinë dhe saktësinë e SKP.

### **Strategjitë**

Së fundi do të harton një sërë strategjish, të cilat pasi të zbatohen, do të radhitin marrëveshjet aktuale të pagesave me SKP të parashikuar. Këto strategji të marra së bashku do të përfaqësojnë një sërë iniciativash të dakorduara të cilat do të zbatohen në bashkëpunim me njëri-tjetrin nga të gjitha grupet e interesit. Ky ndryshim programi do të zbatohet nën udhëheqjen e BQK-së në konsultim me komunitetin e pagesave dhe do të përfshijë një sërë aktiviteteve për këtë qëllim, për shembull, reduktim të rrezikut, forcim të kornizës ligjore dhe rregullatore të punës, praktikave të pagesave, ndërfaqe ndërmjet sistemeve treguese dhe SKP, dhe menaxhimin e SKP. Me kalimin e kohës shembuj të strategjive të tilla mund të jenë edhe:

- Qartësim të roleve dhe përgjegjësi të të gjithë pjesëmarrësve në SKP;
- Prezantim i masave për të kufizuar ekspozimet e kreditit në pjesën më të madhe të proceseve të kliringut;
- Rishikim i pushtetit statutor të BQK-së në lidhje me sistemet e pagesave;
- Prezantimi i një kornize pune rregullatore për ofruesit e shërbimeve të shlyerjes;
- Krijim të marrëveshjeve mbi pjesëmarrjen për të përdorur investime të përbashkëta në infrastrukturë;
- Krijimin e KKP i cili do të diskutojë dhe zgjidhe çështjet relevante në fushën e pagesave;
- Krijimin e standardeve të SKP;
- Lidhje me bankat dhe autoritetet financiare në rajon dhe më gjerë në Evropë; dhe
- Rishikim të praktikave të tregut të monedhës së huaj/ përtej kufirit, nga perspektiva e SKP.

## IV. SHTYLLAT E VIZIONIT TË SISTEMIT TË PAGESAVE

Vizioni bazohet në nëntë shtylla, të cilat së bashku mbulojnë plotësisht të gjitha elementet e SKP. Ato janë:

Shtylla I:	Korniza ligjore e punës
Shtylla II:	Pagesat me vlera të mëdha dhe ato me afat
Shtylla III:	Sistemet e pagesave individuale
Shtylla IV:	Transaksionet e Qeverisë
Shtylla V:	Depozitat e letrave me vlerë, kliringut dhe shlyerjes
Shtylla VI:	Tregjet monetare
Shtylla VII:	Remitancat nga jashtë
Shtylla VIII:	Mbikëqyrja
Shtylla IX:	Bashkëpunimi

Për secilën nga nëntë shtyllat, kjo pjesë përshkruan shkurt parimet në të cilat ato mbështeten, dhe përkufizon gjendjen e dëshiruar të SKP në të ardhmen në Kosovë në kontekst të secilës shtyllë në veçanti. Për të arritur gjendjen e dëshiruar në të ardhmen nevojitet zbatimi i një sërë projektesh zhvillimore individuale. Këto përshkruhen në secilën shtyllë në veçanti po në lidhje me planin e veprimit, i cili përmban detajet praktike të çdo projekti përfshirë buxhetin e llogaritur për projekt dhe tabelën kohore të zbatueshmërisë së tij.

### SHTYLLA I. KORNIZA LIGJORE E PUNËS

*Një kornizë e fortë dhe e duhur ligjore e punës është baza për një SKP të qëndrueshëm dhe efikas. Ambienti ligjor duhet të përmbajë siç vijon:*

- 1. Ligje dhe rregullore gjerësisht të zbatueshme të cilat adresojnë çështje të përgjithshme si insolvenca (paafësi pagese) dhe marrëdhëniet kontraktuale midis palëve;*
- 2. Ligje dhe rregullore që kanë aplikim të veçantë në sistemet e pagesave (si: legjislacioni mbi nënshkrimet elektronike, vlefshmëria e rrjetit, finalizim i shlyerjeve); dhe*
- 3. Rregullat, standardet dhe procedurat e dakorduara nga pjesëmarrësit në një sistem pagesash.*

*Infrastruktura ligjore duhet të mbulojë gjithashtu aktivitete të tjera të realizuara si nga organe të sektorit privat gjithashtu edhe nga ato të sektorit publik. Për shembull, korniza legjislative e punës duhet të përcaktojë qartë përgjegjësitë e Bankës Qendrore të tilla si mbikëqyrja e sistemit të pagesave apo provizioni i likuiditetit ndaj pjesëmarrësve në këto sisteme. Së fundi, pjesë të tjera relevante të legjislacionit të cilat kanë ndikim në mirëfunksionimin e kornizës ligjore të punës së sistemit të pagesave mund të përfshijnë:*

- 1. Ligj mbi transparencën e instrumenteve të pagesave – kushtet dhe rrethanat;*

2. *Legjislacioni Antitrust për furnizimin e shërbimeve të pagesave; dhe*
3. *Legjislacioni mbi intimitetin.*

*Ndërkohë që zakonisht ligjet janë mënyra e duhur për të detyruar të zbatohet objektivi i përgjithshëm në sektorin e pagesave, në disa raste rregulloret e sektorit të mbikëqyrës janë më efikase për të reaguar në një ambient që ndryshon shumë shpejt. Në raste të tjera mund të jenë të përshtatshme marrëveshje të veçantë ndërmjet pjesëmarrësve; në këtë rast zakonisht kërkohet një vlerësim i duhur profesional për detyrueshmërinë e këtyre marrëveshjeve. Mbasi në këtë rast sistemi i pagesave përfshin pjesëmarrësit e përfshirë në juridiksione të huaja, apo vepron me shumëllojshmëri monedhash apo monedhën e përdorur përtej kufirit, në këto raste mund të shfaqet nevoja të adresohen çështjet që kanë të bëjnë me juridiksionet e huaja.*

*Logjikë e ngjashme aplikohet ndaj sistemeve të shlyerjes së letrave me vlerë. Veprimtaritë e besueshme dhe të parashikueshme të një sistemi të shlyerjes së letrave me vlerë (SSHLV) varen nga:*

1. *Ligjet, rregullat dhe procedurat që përkrahin posedimin, transferimin, mbajtjen peng dhe dhënien hua të letrave me vlerë dhe pagesave që kanë të bëjnë me to;*
2. *Mënyra se si këto ligje rregulla dhe procedura funksionojnë praktikisht, d.m.th nëse operatorët e sistemit, pjesëmarrësit dhe konsumatorët e tyre mund të imponojnë të drejtat e tyre.*

*Nëse korniza ligjore e punës është e papërshtatshme apo zbatimi i saj nuk është i sigurt, mund të kemi rrezik në depozitim apo likuidim për pjesëmarrësit e këtij sistemi dhe konsumatorët e tyre apo rrezik sistematik ndaj tregjeve financiare në tërësi. Performanca e sistemeve të kliringut dhe shlyerjes mund të ndikohet nga një sërë ligjesh dhe konceptesh ligjore. Ligjet e kontratave, ligjet e kompanive, ligjet e falimentimit dhe insolvences, ligjet e kujdestarisë dhe ligjet e pronës mund të pengojnë performancën e një sistemi klerimi. Ekziston nevoja e përgjithshme për një bazë të përshtatshme ligjore e cila është në gjendje të bëjë vend për avancimet në teknologji dhe në këtë mënyrë nuk do të kemi detyrim nga veprimtaria apo zhvillimet e sistemit në të ardhmen. Aspektet kyçe të procesit të shlyerjes të cilat duhet t'i përkrah korniza ligjore e punës janë:*

1. *Imponueshmëria e transaksioneve;*
2. *Mbrojtje e aseteve të konsumatorëve (në veçanti kundrejt insolvences së kujdestarëve);*
3. *Palujtshëmria apo dematerializimi i letrave me vlerë;*
4. *Marrëveshjet për rrjet (ndërlidhje);*
5. *Huazimi i letrave me vlerë (përfshirë marrëveshjet për riblerje dhe transaksioneve të tjera ekonomikisht ekuivalente);*
6. *Finalizimi i shlyerjeve;*
7. *Marrëveshje për të realizuar DkP;*
8. *Rregullat për kundërvajtje;*

9. Likuidimi i aseteve të lëna peng apo të transferuara si kolataral; dhe
10. Mbrojtje të interesave të pronareve përfitues.

*Rregullat dhe kontratat që kanë të bëjnë me veprimtarinë e SSSLV duhet të jenë të obligueshme në rast të insolvenses së një sistemi pjesëmarrës, nëse pjesëmarrësi është pozicionuar në juridiksion ligjet e të cilit qeverisin SSSLV apo në ndonjë juridiksion tjetër.*

**Shtylla I: Sistemet e Pagesave në Kosovë funksionojnë në një ambient ligjor të sigurt e të fuqishëm i cili është në gjendje të përballojë finalizimin e shlyerjeve dhe efikasitetin e marrëveshjeve të pagesave. Saktësisht:**

1. BQK-ja përkrah një kornizë të shëndoshë ligjore pune për shlyerjen e pagesave dhe letrave me vlerë dhe është vazhdimisht duke kërkuar të forcojë ambientin ligjor dhe rregullator në Kosovë. Brenda BQK-së është formuar një ekip ligjor i cili do të adresojë të gjitha çështjet e mbetura pezull dhe përgatit legjislacionin e propozuar, si atë parësor edhe atë dytësor.
2. Si bazë për të siguruar stabilitet dhe efikasitet, BQK do të përkrahë dhe inkurajojë fuqishëm, legjislacionin mbi:
  - a. Urdhëresat mbi kliringun dhe shlyerjen e pagesave dhe letrave me vlerë, përfshirë rregullat mbi kolateralin;
  - b. Mbikëqyrjen e sistemit të pagesave; dhe
  - c. Transferet elektronike, për të lejuar njohje të plotë të metodave moderne të pagesave dhe për të përkrahur ndërveprimtarinë.
3. Çdo pjese e legjislacionit, përfshirë rregullat dhe rregulloret e të gjithë sistemeve, do të diskutohen me grupet e tjera të interesit. Objektivi i përgjithshëm është të arrihet një marrëveshje e përgjithshme në një organ legjislativ të koordinuar ku secili nga grupet e interesit luan rolin e vet dhe ekziston legjislacionin relevant parësor dhe dytësor, si dhe marrëveshjet bankare.
4. BQK-ja do të startojë një rishikim të hollësishëm të ambientit ligjor dhe rregullator të SKP në Kosovë, dhe do të financojë legjislacionin që do të rezultojë prej tij, në veçanti një ligj të detajuar mbi pagesat.

## **SHTYLLA II. PAGESAT ME VLERË TË MADHE DHE ATO URGJENTE**

*Sistemet për përpunimin e pagesave me vlerë të madhe dhe atyre me afat janë komponentët më domethënës të SKP. Ata janë përkufizuar si sisteme pagesash sistematikisht të rëndësishëm (SPSR), sepse janë në gjendje të krijojnë dhe transmetojnë shqetësime të natyrës së sistemit ndaj sektorit financiar. Në mënyrë që të përballohen këto rreziqe sistemi, zakonisht ndërmerren disa masa në varësi të natyrës së sistemit me vlerë të lartë. Nëse sistemi karakterizohet nga një shlyerje e ngadalësuar në rrjet të transaksioneve të pagesave, masat për kontrollin e rrezikut përfshijnë prezantimin e helmetave bilaterale dhe multilaterale, zbatimin e marrëveshjeve mbi ndarjen e humbjeve, dhe pengun e kolateralit për të përballuar paaftësinë e një apo më shumë pjesëmarrësve për të paguar. Nga ana tjetër, zhvillimi i sistemeve të SHPKR*



*është një përgjigje ndaj rritjes së vetëdijes mbi nevojën për menaxhimin e duhur të rrezikut në sistemet e transferimit të fondeve me vlerë të madhe. Sistemet SHPKR mund të ofrojnë një mekanizëm të fuqishëm për të kufizuar shlyerjet dhe rreziqet e sistemit në procesin ndërbankar të shlyerjeve, sepse ato mund të ndikojnë shlyerjen përfundimtare të transferimit të fondeve individuale në bazë të vazhdueshme gjatë ditës. Për më tepër, sistemet SHPKR mund të kontribuojnë në reduktimin e rrezikut të shlyerjeve të letrave me vlerë dhe transaksioneve të këmbimit valutor duke lehtësuar mekanizmat DkP dhe PkP.*

*Në disa shtete janë prezantuar variante të sistemit bazë SHPKR, të ashtuquajtur sisteme hibride, të cilët marrin parasysh tiparet e ruajtjes së likuidimit që ekzistojnë në sistemet e shlyerjes në rrjet. Këto sisteme mund të ofrojnë përpunim, klerim dhe shlyerje për një sërë instrumente pagesash përveç atyre me vlerë të madhe, me afat apo pagesat individuale ndërbankare. Në juridiksione të pakta të karakterizuara nga vëllimi i përgjithshëm i kufizuar pagesash, infrastruktura SHPKR e përdorur për pagesa me vlerë të madhe dhe me afat mund të përdoret gjithashtu për të realizuar këto pagesa të tjera me modalitete të ndryshme të shlyerjes.*

**Shtylla II: Mekanizmat e shlyerjes së pagesave me vlerë të madhe dhe atyre me afat në Kosovë, janë të sigurta dhe efikase, dhe përputhen plotësisht me Parimet Bazë të KSPSH për SPSR. Saktësisht:**

1. Të gjithë sistemet e pagesave sistematikisht të rëndësishme në Kosovë do të përputhen me Parimet Bazë të KSPSH për Sisteme Pagesash Sistematikisht të Rëndësishme.
2. BQK do të nxjerrë një deklaratë mbi politikat për kontrollin e rrezikut, pasi të ketë diskutuar gjithçka që përfshihet në të me të gjitha grupet e interesit. Këtë dokument do të kërkohet ta mbështesin të gjithë sistemet dhe pjesëmarrësit e tyre. Grupet e interesit do të angazhohen të aplikojnë politikat e nxjerra.
3. BQK do të aktivizojë një sistem modern SHPKR brenda sistemit operativ të pagesave, i cili ka për qëllim të përfaqësojë shtyllën e SKP në Kosovë dhe do të zëvendësojë marrëveshjet aktuale mbi kliringun dhe shlyerjet për pagesat prioritare në SEKN. Ky sistem do të ketë rregulla dhe procedura të qarta, të cilat do të sqarojnë të gjitha mjetet për të menaxhuar rreziqet ligjore, financiare dhe operacionale. Hartimi i sistemit do të përfshijë pajisjen me mjete menaxhuese për të përballuar rreziqet e likuiditetit. Ato përfshijnë:
  - a. Pajisjen me mekanizmat për radhitje duke prezantuar mekanizmat më të favorshëm;
  - b. Pajtim me pjesëmarrësit e sistemeve mbi orët më efikase të veprimit dhe themelimin e ndërlidhjeve të duhura dhe efikase ndërmjet sistemeve; dhe
  - c. Krijim të rutinës për t'i kanalizuar pagesat e Qeverisë herët gjatë ditës së operimit.

Në periudhën afatmesme sistemi duhet të ofrojë likuidim brenda ditor të kolateralizuar, për aq kohë sa letrat me vlerë të likuidueshme gjenden në tregun financiar në Kosovë.

4. Hartimi i sistemit do të përfshijë:
  - a. Përforsimin e masave të caktuara të sigurisë ndaj qasjes fizike apo elektronike në sistem;
  - b. Zbatim të përshpejtuar të planeve të papritura dhe mekanizma për ripërtëritje të fatkeqësive, përfshirë njësitë për përpunim dytësor dhe qarqe alternative në rrjet; dhe
  - c. Zbatim të masave për vazhdimësi të biznesit dhe elasticitet në SKP.
5. BQK momentalisht është duke taksuar për shërbimet e saj të pagesave. Politikat e çmimeve për sistemet e reja të pagesave do të jenë pjesë e objektivave të përgjithshme të reformave të sistemit të pagesave. BQK do të hartojë politikën mbi ripërtëritjen e çmimeve bashkë me politikat e objektivave të përgjithshme të saj, dhe ka për qëllim që përfitimet e përfuara t'u kalojnë përdoruesve përfundimtar. Politika e çmimeve do të rishikohet rregullisht për të marrë në konsideratë rrethana të ndryshme.
6. Kriteret e qasjes (përfshirë “dil” dhe “përjashto”) do të përcaktohen qartë në bazë jodiskriminuese. Duhet të realizohen marrëveshje ndërlidhëse për të mundësuar reduktimin e procedurave manuale nëpërmjet pjesëmarrjes indirekte. Si fillim, pjesëmarrja direkte në sistem do t'u lejohet vetëm bankave.
7. Qëllimi dhe mandati i KKPN do të zgjerohet për të përfshirë SHPKR. Në kontekst të politikës së transparencës BQK do të publikojë rregullat e hapura të sistemit dhe çdo dokumentacion tjetër të nevojshëm.
8. Sistemi operativ i BQK-së do të integrohet në mënyrë të sigurt dhe efikase në një proces të drejtpërdrejtë me sistemet e tjera. SHPKR do të përdoret për shlyerjet finale të sistemeve të shitjes me pakicë si dhe do të vendosen ndërfaqet e duhura. Sistemi SHPKR do të integrohet me të gjitha sistemet për shlyerjen e letrave me vlerë në të ardhmen për të realizuar DkP dhe me sistemet e tregut ndërbankar për të realizuar PkP. Në të ardhmen, ndërfaqet me platforma tregtimi për tregjet e letrave me vlerë dhe tregjet ndërbankare do të hartohen për të garantuar menaxhim efikas të likuidimit për institucionet financiare.

### **SHTYLLA III. SISTEMI I PAGESAVE ME VLERA TË VOGLA**

*Një numër i madh i instrumenteve të pagesave është i domosdoshëm për të përkrahur nevojat e konsumatorëve në ekonominë e tregut. Një furnizim më pak se optimal i instrumenteve të pagesave mundet si përfundim të ketë ndikim në zhvillimin dhe rritjen ekonomike. Për më tepër, përdorimi i sigurt dhe efikas i parave si mjet shkëmbimi në transaksionet individuale është shumë i rëndësishëm për stabilitetin e monedhës dhe themelimin e besimit që njerëzit kanë në të. Ashtu si kanë treguar publikimet e KSSHP<sup>11</sup>, përdorimi i instrumenteve individuale të pagesave ndryshon në vendet e*

<sup>11</sup> Banka për Shlyerje Ndërkombëtare, Komiteti mbi Sistemet e Shlyerjeve dhe Pagesave, *Marrëveshjet mbi Kliringun dhe Shlyerjen e Pagesave Individuale në vendet e përzgjedhura (Shtator 200)*; dhe *Sistemet e Pagesave Individuale në Vendet e Përzgjedhura: Studim Krahasues (Shtator 1999)*, Basle, Zvicër.

*industrializuara si brenda shtetit ashtu edhe ndërmjet shteteve. Kjo për shkak të një sërë arsyesh përfshirë faktorët kulturor, ekonomike, historike dhe ligjore. Gjithsesi mund të vërehen disa tendenca të përbashkëta, përkatësisht:*

1. *Parësia e vazhdueshme e parasë (për sa i përket volumit) për pagesat ballë për ballë;*
2. *Rritja e përdorimit të pagesave me kartelë;*
3. *Rritja e përdorimit të transferimit direkt të fondeve, sidomos transferimit direkt të debiteve, për pagesat në distancë; dhe*
4. *Ndryshime në marrëveshjet e tregut për të ofruar dhe çmuar instrumentet e pagesave individuale dhe shërbimet e përcjella tek përdoruesit përfundimtar.*

*Ky evolucion ka gjasa të vazhdojë në të ardhmen dhe pritet të influencojë instrumentet tradicionale (sidomos ato të letrës). Sipas raporteve të KSSHP, për periudhën afatgjate disa nga zhvillimet e tregjeve të vëzhguara mund të ndryshojnë më së miri praktikën tradicionale të pagesave dhe të kontribuojnë në rritjen e efikasitetit dhe leverdinë e sistemit të pagesave individuale. Vazhdimisht po rritet numri i shteteve të cilët po u kushtojnë gjithnjë e më shumë vëmendje autoriteteve dhe pjesëmarrësve të tregut në efektshmërinë dhe efikasitetin e prodhimit dhe shpërndarjes së instrumenteve të pagesave (përfshirë keshin-paranë).*

*Në shtator 2002, KSSHP publikoi një raport<sup>12</sup> i cili identifikoi dhe shqyrtoi çështje të politikave për bankat qendrore dhe kontributin e mundshëm të bankave qendrore në çuarjen përpara të disa objektivave të politikave në këtë fushë. Bankat qendrore janë aktualisht të përfshira në pagesat individuale në tre mënyra kryesore:*

1. *Në një kapacitet operacional (veçanërisht si agjent pagesash për qeverinë dhe operatorë të sistemit gjithashtu);*
2. *Si mbikëqyrës së sistemit të pagesave; dhe*
3. *Si katalizatorë apo lehtësues të tregut edhe evolucion rregullator.*

*Edhe pse përfshirja e Bankës Qendrore në pagesat individuale varion nga një vend në tjetrin, raporti sugjeron se çdo bankë qendrore duhet të shqyrtojë periodikisht zhvillimet në tregun e saj në perspektivën e disa çështjeve të politikave të identifikuar, në mënyrë që të krijojë një ide nëse çështje të tilla duhen ngritur në praktikë. Kur gjykohet se çështje të tilla duhet të ngrihen, autoritetet publike relevante (përfshirë bankat qendrore) mund të vendosin të marrin masa duke synuar të themelojnë apo rithemelojnë një balanc të pranueshëm të disa aspekteve të sigurisë dhe efikasitetit. Qëllimet e politikave publike, masat minimale të bankës qendrore, dhe gama e masave të mundshme shtesë të identifikuar në Raportin e KSSKP janë përmbledhur në aneksin 5.*

<sup>12</sup> Banka për Shlyerje Ndërkombëtare, Komiteti mbi Sistemet e Shlyerjeve dhe Pagesave, *Çështje të Politikave për Pagesat Individuale në Bankat Qendrore* (Mars 2003).

**Shtylla III: Sistemet e pagesave individuale në Kosovë janë efikase, të duhura dhe ndërvepruese si dhe mbështesin ofrimin e një game të gjerë instrumentesh dhe shërbimesh pagesash.**

1. BQK-ja do të vazhdojë të luajë një sërë rolesh në sistemet individuale duke përfshirë agjent të shlyerjeve, operator, pjesëmarrës, mbikëqyrës dhe fatalistë për ndryshime. Objektivi i përgjithshëm është ti ofrojë ekonomisë me një bazë të gjerë shërbimesh efikase dhe të sigurta pagesash.
2. Të paktën një Sistem Automatik i Pagesave Individuale (ACH) do të veprojë në Kosovë dhe do të disenjohet në mënyrë efikase për të mbështetur dhe përsheptuar lëvizjen drejt instrumenteve elektronike të kreditimit. BQK-ja do të vazhdojë të lërë në veprim një ACH (për momentin SEKN) për pagesat elektronike pa afat. Formatet e mesazheve të pagesave do të delegohen në standardet ISO 15022 (SWIFT).
3. BQK-ja do të sigurohet që të gjithë ACH (aktuale dhe në të ardhmen) në Kosovë të jenë lidhur si duhet me aplikacionin SHPKR për shlyerje.
4. BQK-ja do të rishikojë të gjitha rregullat dhe rregulloret për ACH- të. Në veçanti, do të mbulohen artikujt më poshtë:
  - a. Përkufizimi dhe karakteristikat e sistemit/eve;
  - b. Kriterin e qasjes;
  - c. Udhëzimet operative përfshirë sanksionet që do të aplikohen në rast mospërputhjeje;
  - d. Përgjegjësitë e ACH dhe pjesëmarrësve në sistem;
  - e. Kontrollat e nevojshme;
  - f. Strukturat e mesazheve;
  - g. Marrëveshjet e rastësishme;
  - h. Komisioni shkëmbimor; dhe
  - i. Zgjidhje e konflikteve.
5. Operatori/ët e sistemit, përfshirë BQK-në, do të mbajnë një dialog me grupet kryesore të interesit, nëpërmjet veprimtarisë së KKPN.
6. Organe të tjera financiare ose jofinanciare mund të vënë në veprim sisteme pagesash individuale, në veçanti për pagesat me kartelë, ose të ofrojnë shërbime pagesash individuale. Në lidhje me këtë BQK-ja do të luajë një rol katalizues për realizimin e kyçjes së kartelave kombëtare ndërbankare<sup>13</sup>, e vënë në veprim në bazë paanshmërie dhe mosdiskriminimi nga sektori bankar.
7. Të gjitha sistemet individuale do të mbikëqyren nga BQK-ja (shih shtyllën VIII) në emër të sigurisë dhe efikasitetit të tyre, duke ju kushtuar vëmendjen e duhur instrumenteve të ndryshme në varësi të nivelit të rrezikut që ato paraqesin në sistemin financiar.

---

<sup>13</sup> Kyçja e kartelës është një formë ACH e cila përpunon transaksionet me kartelë.

8. Të gjitha qarqet individuale do të karakterizohen nga një shkallë e lartë ndërveprimi dhe efikasiteti i lartë për sa ju përket cikleve të tyre të kliringut.
9. Politikat e çmimeve për qarqet individuale janë formuluar në një mënyrë e cila merr parasysh parimin se kostot realizohen duke marrë parasysh rritjen e përfitimit, dhe në përputhje me objektivat më efikase. BQK-ja do të rishikojë politikat e rimëkëmbjes së kostove për t'i bërë ato në përputhje me objektivat e politikave të përgjithshme të SKP, dhe ka për qëllim që përfitimet e përftuara t'u kalojnë përdoruesve përfundimtar.
10. Parandalimi efikas i gabimeve dhe masat e detektimit janë përcaktuar për të gjitha sistemet individuale dhe bërja e gabimeve në të gjithë fluksin e pagesave është në nivele të pranueshme. Objektiv i rëndësishëm do të ishte themelimi i mekanizmave të duhur për mbrojtjen e konsumatorit në të gjitha sistemet.

#### **SHTYLLA IV. TRANSAKSIONET QEVERITARE**

*Në të gjitha shtetet, sektori publik është përdoruesi më i madh i sistemit të pagesave. Në fakt Qeveria merr dhe dërgon shumë pagesa (për mbledhjen e tatimeve, taksave doganore dhe taksa të tjetra dhe pagesat e rrogave dhe pensione, taksat mbi mallrat dhe shërbimet, etj.) Sektori publik në Kosovë është pjesëmarrës aktiv (përmes BQK) në marrëveshjet aktuale të pagesave dhe transaksionet ndërbankare qeveritare të cilat realizohen përmes SEKN*

**Shtylla IV: Mbledhja e të ardhurave dhe shpenzimet qeveritare janë të integruara plotësisht dhe në mënyrë efikase në SKP në Kosovë dhe përkrahin funksionimin e tij.**

1. Marrëveshjet aktuale për transaksionet e pagesave qeveritare (pagesat ndaj organeve të jashtme dhe mbledhja e të ardhurave) do të vlerësohen vazhdimisht me fokusin për të siguruar se është përfituar plotësisht nga SKP i reformuar, duke marrë parasysh faktin se transaksionet qeveritare përbejnë një përqindje domethënëse të të gjitha transaksioneve në sistem. Pagesat për shpenzime dhe mbledhja e të hyrave të sektorit publik do të vazhdojë të realizohet në mënyrë elektronike duke përdorur sistemin aktuale dhe atë të parashikuar për të ardhmen. Kjo është për të garantuar se të gjitha përfitimet e reformës së pagesave do të rrjedhin nga të gjitha segmentet në Kosovë nëpërmjet një efikasiteti më të lartë në rrjedhën e pagesave në saje të nevojës për të mbajtur me pak burime të kota në llogaritë bankare.
2. Në periudhën afatshkurtër, përmirësimet në efikasitet do të kërkohen në saje të zbatimit të ndërfaqeve plotësisht të automatike ndërmjet sistemit të veçantë të menaxhimit të Thesarit dhe sistemeve relevante të përdorura nga BQK. BQK gjithashtu do të punojë vazhdimisht me doganat dhe Administratën Tatimore për të gjetur mënyrat për përmirësim të efikasitetit dhe leverdinë e mbledhjes së të hyrave.
3. Në periudhën afatgjatë, BQK do të vazhdojë t'i ofrojë mbështetje Ministrisë së Administratës Publike në projektin e saj për të realizuar një portal të përbashkët interneti për të gjitha pagesat e Qeverisë.

## SHTYLLA V. DEPOZITA E LETRAVE ME VLERË, KLIRINGU DHE SHLYERJA

*Tregjet e letrave me vlerë kanë një rendësi të veçantë për sektorin financiar të një shteti. Në fakt, në ekonomitë e zhvilluara, letrat me vlerë dhe mbi të gjitha letrat me vlerë të Qeverisë, përdoren gjerësisht për të realizuar politikat monetare nëpërmjet veprimtarive të tregut të hapur. Gjithashtu SSSLV janë të domosdoshme për dërgesat me afat të kolateralit për pagesa dhe qëllime të tjetra. Procedurat e duhura dhe efikase për shlyerjen e letrave me vlerë janë një element i rëndësishëm për zhvillimin e tregut financiar.*

*Veprimtari e besueshme dhe e pritshme e SSSLV varet nga:*

- 1. Ligjet, rregullat dhe procedurat që përkrahin mbajtjen, transferimin, pengun dhe huadhënien e letrave me vlerë dhe pagesave që kanë të bëjnë me to; dhe*
- 2. Sesi këto ligje, rregulla dhe procedura funksionojnë në praktike, që do të thotë, nëse operuesit e sistemit, pjesëmarrësit dhe konsumatorët e tyre mund t'i mbrojnë të drejtat e tyre.*

*Nëse korniza ligjore është e papërshtatshme apo aplikimi i saj nuk është i sigurt, mund të sjell rrezik kreditimi apo likuidimi për pjesëmarrësit në sistem dhe konsumatorët e tyre apo ndaj rreziqeve sistematike për tregjet financiare ne përgjithësi.*

*Siguria e SSSLV është e një rëndësie të veçantë si nga pjesëmarrësit edhe nga perspektiva rregullatore ndaj duhet t'i kushtohet vëmendje e veçantë. Procesi i shlyerjeve ekspozon pjesëmarrësit e tregut dhe sistemet e shlyerjeve dhe kliringut ndaj rreziqeve të ndryshme. Sistemi duhet të hartohet në mënyrë të tillë që të minimizojë këto rreziqe. Ngurtësimi (bllokimi) apo dematerializimi i letrave me vlerë redukton ose eliminimin disa rreziqe. Transferimi i letrave me vlerë duke i shënuar në regjistër është parakusht për shkurtimin e ciklit të shlyerjeve për tregjet e letrave me vlerë, gjë që redukton koston e rrezikut për zëvendësim.*

*Rreziku më i madh i shlyerjeve është rreziku i homologimit (rreziku i parimit/kreditit). DkP është një nga mënyrat kryesore me të cilën tregu mund të reduktojë rrezikun e pranishëm në transaksionet e letrave me vlerë. Koncepti DkP kërkon të eliminojë rrezikun thelbësor nga transaksionet e letrave me vlerë duke siguruar se shitësit heqin dorë nga letrat e tyre me vlerë vetëm atëherë kur ju paguhen plotësisht dhe e kundërta. Ekzistojnë tri elemente kryesore në një transaksion DkP:*

- 1. Shpërndarje e mirë dhe e p kthyeshme e letrave me vlerë;*
- 2. Fonde përfundimtare dhe të pakthyeshme; dhe*
- 3. Shkëmbim simultan.*

*Përdorimi i homologimit qendror që ndërfitet ndërmjet palëve homologe të tregjeve të letrave me vlerë po bëhet një praktikë përherë e më e zakonshme. Është mbi të gjitha një mjet efektiv për të reduktuar rrezikun ballë për ballë pjesëmarrësve të tregut aktiv. Por përdorimi i homologut qendror përqendron rrezikun dhe e rivendos rrezikun*

ndërmjet pjesëmarrësve të tij në saje të politikave dhe procedurave të menaxhimit të rrezikut. Aftësia e sistemit në tërësi për të përballuar mospagimin e pjesëmarrësve individual varet së tepërmi nga procedurat e menaxhimit të rrezikut të homologut qendror dhe qasjen e tij në mjete për të absorbuar humbjet financiare.

Ekzistojnë një sërë procedurash të menaxhimit të rrezikut për të reduktuar rrezikun e tregut dhe për të forcuar një mekanizëm DkP. Këto procedura përfshijnë standardet e pranimit, monitorimin a ja vlen t'u jepet kredi anëtarëve, risitë, fondet pjesëmarrëse, shkrirjet e kolateraleve, blerjet dhe shitjet, majat neto të debitit, kufijtë bilateral të kreditimit dhe marrëveshjet për ndarjen e humbjeve. Shumica e sistemeve të shlyerjeve përdorin më shumë se një procedurë për të minimizuar rrezikun e tregut. Për më tepër ekzistojnë një sërë mekanizmash për përmirësim të proceseve të shlyerjes. Në mes tyre janë:

1. Lehtësirat kryesore për huadhënie;
2. Lehtësirat për regjistrim të pengut; dhe
3. Procedurat e menjëhershme të reregjistrimit.

Huadhëniet dhe huamarrjet e letrave me vlerë të rregulluara si duhet mund të sjellin përfitime domethënëse për tregun dhe përdoruesit e tij, duke çuar drejt një tregu me likuid. Shitja për një kohë të shkurtër mund të jetë një mekanizëm i nevojshëm për të rritur likuiditetin. Gjithsesi kur lejohet shitja për një kohë të shkurtër, rregulloret duhet të kujdesen ndaj praktikave manipuluese, përfshi ato të shoqëruara nga një rang shumë i ulët.

Finalizimi i pagesave dhe transferimi i pronësisë së letrave me vlerë është faktor kyç në zhvillimin e tregut të letrave me vlerë. Përndryshe në treg do të operojnë vetëm investitorët lokal dhe vetëm të bazuar në marrëdhënie të themeluara mirë ndërmjet klientëve si dhe koifidencen që këto marrëdhënie ofrojnë. Në tregjet e hapura, ky faktor është i një rëndësie vendimtare nëse ekziston dëshira për të tërhequr investimet e huaja. Investitorët e huaj do të nguronin të merrnin pjesë në një treg që nuk konsiderohet i sigurt. Finalizimi i pagesave është po aq i rëndësishëm.

Dështimi i çdo banke që ofron llogari të keshit për të shlyer obligimet e pagesave për anëtarët e DQLV mund të shkëpusë shlyerjen dhe të rezultojë në humbje domethënëse dhe presion likuidimi. Përdorimi i bankës qendrore si banka e vetme për shlyerje nuk do të ishte gjithmonë e praktikueshme. Në raste të tilla një bankë private ndonjëherë përdoret si e vetmja bankë për shlyerje dhe duhet të ndërmerren hapa për të mbrojtur anëtarët e DQLV nga humbjet e mundshme dhe presioni i likuiditetit që do të lindnin nga dështimi i saj.

Sa i përket rregullores dhe mbikëqyrjes nga autoritetet, nevojitet shpërndarja e duhur e përgjegjësive për mbikëqyrjen e klerimit dhe shlyerjes së letrave me vlerë. Gjithsesi, në shumicën e rasteve, ky funksion realizohet bashkë me funksionin e mbikëqyrjes së përgjithshme të organeve pjesëmarrëse pa i kushtuar vëmendje të veçantë çështjeve të kliringut apo shlyerjes. Ekzistojnë tendenca që politikat rregullatore të mbikëqyrjes të zbatohen në dy nivele për të zëvendësuar aktivitetet tradicionale të mbikëqyrjes direkte. Rregullatori drejton mbikëqyrjen e aktiviteteve të Organizatave Vetë Rregullatore

(OVR) (DQLV, shkëmbimet), ndërkohë që këto institucione kryejnë të njëjtin funksion në lidhje me pjesëmarrësit e tyre.

Një rregullator i letrave me vlerë duhet të ketë autoritetin për të licencuar sisteme automatike të pagesave individuale dhe (Operatore Sistemesh) DQLV si OVR dhe të rishikojë dhe të aprovojë rregullat e tyre. Si një OVR, një operator sistemi duhet të ketë autoritetin të krijojë rregulla dhe t'i detyrojë pjesëmarrësit e tij t'i zbatojnë ato. Rregullatori i letrave me vlerë duhet të ketë pushtetin të hartojë udhërrëfyesit të cilët duhet t'i ndjekin operatorët e sistemeve. Për më tepër, rregullatori i letrave me vlerë duhet të sigurohet se rregullat dhe procedurat e nxjerra nga OVR-të sigurojnë një veprimtari të mirë dhe efektive të sistemit dhe ofrojnë qasje të drejte ndaj të gjithë pjesëmarrësve të tregut. Rregullatori i letrave me vlerë duhet gjithashtu të ketë autoritetin të realizojë inspektime të herë pas hershme, të kërkojë raporte periodike dhe të detyrojë zbatimin e ligjeve dhe rregullave për letrat me vlerë. Bashkëpunimi i dy anshëm ndërmjet rregullatorëve të letrave me vlerë dhe bankës qendrore si dhe bashkëpunimi i tyre me institucione të tjera relevante është i rëndësishëm për të arritur qëllimet e politikave të gjithsecilit.

Është pranuar gjerësisht se një treg i letrave me vlerë duhet të përkrahet nga DQLV me pjesëmarrjen sa më të gjerë të mundshme të industrisë. Pranimi duhet të jetë i hapur për të gjithë pjesëmarrësit e kualifikuar të tregut që kanë nevojë për qasje në DQLV. Duhet të përcaktohen standardet e anëtarësimit për të gjithë operatorët e sistemit në mënyrë që të minimizohet rreziku. Disa standarde minimale të përgjegjësisë financiare, kapacitetit operacional (përfshi sigurinë dhe integritetin e sistemit), eksperiencën dhe kompetencat duhet të përmbushen për të marrë pjesë në sisteme. Kërkesat kryesore të detyrueshme për pjesëmarrësit janë rrjeti i parë i sigurisë për t'u mbrojtur nga dështimi i pjesëmarrësve, dhe për pasojë janë edhe një mjet i rëndësishëm për menaxhimin e rrezikut. Gjithsesi këto kërkesa hartohen herë pas here për arsye të tjera veç kliringut dhe shlyerjes dhe një operator sistemi duhet të ketë autoritetin për të imponuar standarde më të larta financiare tek anëtarët/pjesëmarrësit e tij nëse kërkesat e përgjithshme nuk mbulojnë si duhet rrezikun e parashikuar. Rregullat për organizatat e kliringut dhe ato depozituese duhet të shmangin diskriminimin e padrejtë në lidhje me pranimin e pjesëmarrësve apo ndërmjet pjesëmarrësve në përdorimin e sistemit. Rregullat duhet të ofrojnë procedura të drejta për rishikim të vendimeve që kanë të bëjnë me refuzimin apo pranimin. Për më tepër sistemi duhet t'u ofrojë pjesëmarrësve një mundësi kuptimplote për të marrë pjesë në administrimin e punëve të organizatës.

Një strukturë e vetme e rregullave të qeverisjes nuk është e përshtatshme për të gjitha institucionet brenda tregjeve të ndryshme të letrave me vlerë dhe skemave rregulluese. Megjithatë, një institucioni i qeverisur në mënyrë efektive duhet t'i plotësojë disa kërkesa themelore. Rregullat e qeverisjes duhet të artikulohen qartë, të jenë koherente, të kuptueshme dhe plotësisht transparente. Prandaj, rregullat e qeverisjes duhet të kërkojnë të minimizojnë konfliktet ndërmjet objektivave të pronarëve, shfrytëzuesve dhe palëve tjera të interesit, dhe të zgjidhin ato në mënyrën më efektive të mundshme ku pjesëmarrësit kanë të drejtë qasjeje në informatat relevante lidhur me rreziqet ndaj të cilave ata ekspozohen, si dhe të mund të ndërmarrin veprime për menaxhimin e atyre rreziqeve. Nevoja për transparencë vlen për subjektet të cilat përbëjnë kliringun, pagesat dhe infrastrukturën e mirëmbajtjes së tregjeve të letrave me vlerë.



*Pjesëmarrësit e informuar të tregut janë në gjendje të vlerësojnë më mirë kostot dhe rreziqet ndaj të cilave ata ekspozohen si rezultat i pjesëmarrjes në sistem. Informatat relevante duhet të jenë në dispozicion të pjesëmarrësve në treg. Informatat duhet të jenë aktuale dhe në dispozicion sipas formatit që plotëson nevojat e shfrytëzuesve.*

**Shtylla V: Kliringu, pagesat dhe sistemet e depozitimit të letrave me vlerë janë në pajtim të plotë me standardet ndërkombëtare dhe kontribuojnë në mbështetjen e zhvillimi të tregjeve të kapitalit.**

1. SSSs në Kosovë do të veprojnë në pajtim me Rekomandimet e KSRRP-ONKL për Sistemet e Pagesave të Letrave me Vlerë. BQK-ja dhe Thesari janë të përkushtuar në këtë objektiv.
2. BQK-ja do të sigurojë dhe instalojë sistemin kompjuterik DQL për trajtimin e letrave me vlerë të Qeverisë kur ato të fillojnë të nxirren. DQL-ja do të jetë e lidhur ngushtë me sistemin BPKR-në (shiko shtyllën II) me qëllim të (i) zbatimit të DvP-së për të gjitha transaksionet e letrave me vlerë dhe (ii) mbështetjes së aktiviteteve ditore të likuidimit nga ana e BQK-së në sistemin e BPKR-së.
3. Pagesa e letrave me vlerë dhe fondeve do të ndërlidhen më qëllim që të mundësohet shlyerja e transaksioneve të letrave me vlerë në bazë të DvP-së, në mënyrë që të eliminohet rreziku kryesor.
4. BQK-ja është fuqimisht në favor të shfrytëzimit të mjeteve të Bankës Qendrore për pagesën e transaksioneve të letrave me vlerë si mënyra më efektive për eliminimin e rrezikut. Instrumentet e shfrytëzuara për pagesën e transaksioneve të letrave me vlerë me anë të keshit sipas vlerës aktuale do të bart tek anëtarët e DQL-së pak apo aspak rrezik të kredisë apo likuidimit.
5. Të gjitha letrat me vlerë do të lëshohen në formë të të hyrave të regjistruar në libër.
6. BQK-ja do të zhvillojë një kornizë rregulluese dhe mbikëqyrëse për depozitim të letrave me vlerë dhe sisteme të pagesave. Kjo do të bëhet nëpërmjet konsultimeve me grupet tjera të interesit, veçanërisht me Thesarin dhe bankat komerciale, dhe nëpërmjet marrëveshjeve formale të bashkëpunimit (psh. Memorandumit të Mirëkuptimit) me palët e tjera (shiko shtyllën IX më poshtë).
7. Marrëveshjet për menaxhim të depozitimit(ëve) duhet të lejojnë një qasje të drejtë dhe të papenguar, t'ju ofrojnë pjesëmarrësve të tregut informata të mjaftueshme me qëllim që saktësisht t'i vlerësojnë rreziqet dhe kostot që ndërlidhen me to. Një depozitim i fuqishëm, i kapitalizuar, autonom dhe i pavarur, me sisteme fleksibile për përshpejtimin e pagesës së transaksioneve dhe të drejtave sekondare është kyç për zhvillimin e një tregu eventual sekondar.

**SEKSIONI 1.02 SHTYLLA VI. TREGJET MONETARE**

*Funksionimi adekuat i tregut ndërbankar të parasë shkon përtej çështjeve të kliringut dhe pagesave. Një mekanizëm efikas për afarizëm dhe rregullimin e këtyre transaksioneve do të mundësonte përmirësimin e menaxhimit të likuidimi dhe në këtë mënyrë, rritjen e sigurisë dhe stabilitetit të sistemit financiar. Veç kësaj, kjo do të*

*ndihmojë në pagesën e letrave me vlerë nëpërmjet shkalës së ulët të interesit e cila do të jetë në dobi të komisionerëve-agjentë gjatë negociimit të linjave kreditore me bankat.*

*Dy elemente kyçe në zhvillimin e tregjeve ndërbankare të parasë përbëjnë një sistem që ka për qëllim të veçantë për pagesa me vlerave të mëdha me qëllim të sigurimit të transferimeve ndërbankare të sigurtat elektronike me anë të kryerjes së menjëhershme të pagesës në sistemin elektronik për regjistrim të letrave me vlerë me qëllim të regjistrimit dhe shënimit të ndryshimeve në pronësi të letrave me vlerë. Zhvillimi i funksionit depozitues paraqet një diskutim të rëndësishëm të cilin duhet ta ndërmarrë një shtet, duke përfshirë autoritete përgjegjëse dhe të gjithë pjesëmarrësit në treg. Duhet të definohet dhe të arrihet pajtimi rreth një strategjie adekuate i cila merr parasysh interesat nacionale dhe le mënjanë interesat e veçanta.*

#### **Shtylla VI: Tregjet ndërbankare të parasë janë plotësisht të zhvilluara dhe drejtpërsdrejti të integruara me sistemet e pagesave**

*Në kuadër të një periudhe afatmesme, BQK-ja do të kërkojë të themelojë një treg ndërbankar të parasë në Kosovë, i cili do të shërbejë si element i rëndësishëm për menaxhmetin e likuidimit. Procedurat, ciklet e kryerjes së pagesave dhe orari i punës do të përcaktohen në mënyrë që të arrihen leverdi maksimale. Korniza ligjore, rregulluese dhe mbikëqyrëse të fuqizohet më qëllim të krijimit të kushteve zhvillimin e tregut ndërbankar të parasë. Si në aspektin afatshkurtër ashtu edhe në atë afatmesëm, BQK-ja do t'i marrë masat e nevojshme për fuqizimin e tregut ndërbankar të parasë.*

### **SEKSIONI 1.02 SHTYLLA VII. DËRGESAT NDËRKOMBËTARE**

*Dërgesat ndërkombëtare janë gjithnjë e më shumë relevante për ekonominë dhe shoqëritë si rezultat i realiteteve aktuale globale, veçanërisht integritit ekonomik në rritje dhe ndërvarësisë ndërmjet shteteve në të gjitha nivelet dhe lëvizjes në rritje të emigrantëve në tërë botën.*

*Nga perspektive e bërjes së politikave, pagesat ndërkufitare me pakicë kanë shumë nga karakteristikat e pagesave vendore me pakicë, dhe shërbimet për shfrytëzuesit e dërgesave ndërkombëtare, sikurse shërbimet tjera të konsumatorëve për pagesë me pakicë, pritet që të ofrohen me anë të një vargu të instrumenteve të parapara më të volitshme, më të lira dhe më të besueshme për mbulimi e kërkesave të tyre më të nevojshme, që do të thotë, pagesat ballë për ballë, pagesat e njëhershme dhe pagesat periodike nga lart si dhe tërheqjet në kesh nga ATM-të. Megjithatë, dërgesat ndërkombëtare mund të jenë të shtrenjta në raport me të hyrat e punëtorëve emigrantë që shpesh janë të ulëta dhe dërgohen në shuma të vogla (zakonisht jo më shumë se disa qindra euro apo të barasvlershme me to në një kohë). Gjithashtu, për emigrantët mund të mos jetë e lehtë të kenë qasje në shërbimet e dërgesave të emigrantëve nëse ata nuk flasin gjuhën vendore apo nuk kanë dokumentacionin e nevojshëm, ndërsa infrastruktura financiare relativisht e pazhvilluar në disa vende mund t'ua bëjë të vështirë marrësvë pranimin e dërgesave nga emigrantët. Në disa raste, shërbimet janë të pasigurta, veçanërisht për sa i përket kohës së nevojshme për transferimin e fondeve.*

*Veç kësaj, disa tregje janë jo konkurruese apo kanë barriera rregullues për ofrimin e shërbimeve të dërgesave nga emigrantët.*

*Në tërë botën ekzistojnë iniciativa për ngritjen e efikasitetit dhe integritetit në ofrimin e shërbimeve të dërgesave ndërkombëtare. Veçanërisht, Banka Botërore dhe KSRRP-ja kanë formuar një grup punues për t'i adresuar nevojat e koordinimit të politikave ndërkombëtare për sistemet e dërgesave ndërkombëtare. Bankat Qendrore nga shtetet dërguese dhe pranuese, institucionet ndërkombëtare financiare, dhe bankat zhvillimore e përbëjnë këtë grup punues, i cili ka nxjerrë Parimet e Përgjithshme për Shërbimet Ndërkombëtare të Dërgesave Ndërkombëtare në janar 2007 (shiko Shtojcën 4). Këto parime të përgjithshme, së bashku me Rekomandimet Speciale të Grupit Punues për Veprimtarinë Financiare (GPVF), japin udhëzime në punën e autoriteteve, agjencie multilaterale dhe ofruesve të shërbimeve në këtë fushë.*

**Shtylla VIII. Pranimi i dërgesave ndërkombëtare dhe pagesat tjera tej kufitare shpërndahen shpejt dhe në mënyrë të duhur në Kosovë, dhe gjithashtu janë efikase nga perspektiva e kostos për shfrytëzuesit në të dy anët e kufirit.**

1. BQK-ja do të punojë me tregun për të siguruar se shërbimet e dërgesave ndërkombëtare në Kosovë janë në pajtim me Parimet e Përgjithshme të BB-KSRRP-në. Në veçanti, BQK-ja do ta përfshijë këtë fushë në aktivitete e sistemit të mbikëqyrjes së pagesave. Qëllimi kryesor do të jetë të promovohet shfrytëzimi më efikas i mundshëm i infrastrukturës së paraparë të pagesave në Kosovë, duke përfshirë atë të institucioneve bankare dhe jobankare.
2. Në afatin e menjëhershëm, BQK-ja do të ndërmarrë një aktivitet të ndërlidhur me bursën kundrejt Parimeve të Përgjithshme të BB-KSRRP-së dhe do të identifikojë në detaje veprimet specifike që do të ndërmerren lidhur me sistemin e tanishëm ekzistues dhe të planifikuar të pagesave në Kosovë.
3. BQK-ja do të siguroj që perspektiva rregulluese të mbulojë çështjet e sistemit të pagesave, në veçanti efikasitetin, transparencën dhe menaxhimin e riskut përveç “çështjeve tradicionale të bilancit të pagesave dhe shpëlarjes së parasë. Eventualisht, në bashkëpunim me autoritetet tjera, ajo do të vendos nëse është e nevojshme nxjerrja e rregulloreve e reja për të siguruar një ofrim të sigurt dhe efikas të shërbimeve në këtë fushë dhe për t'i mbrojtur klientët.

**SEKSIONI 1.02 SHTYLLA VIII. MBIKËQYRJA**

*Lirshmëria dhe siguria në transferimin e parave ndikon në efikasitetin e ekonomisë reale dhe të tregjeve financiare. Forcat e tregut të vetme nuk mund t'i arrijnë objektivat e efikasitetit dhe sigurisë të sistemit të pagesave pasi që pjesëmarrësit dhe operatorët nuk mund të kenë inkurajim adekuate për të minimizuar rrezikun nga dështimi i tyre, apo dështimi i kostove të cilat ua kanë caktuar pjesëmarrësve tjerë. Veç kësaj, struktura institucionale e sistemit të pagesave mund të mos ofrojë inkurajim apo mekanizma për një plan dhe veprim efikas.*

*Ekzistojnë dy arsye se pse në të gjitha shtetet përfshirja e bankave qendrore në sistemin e pagesave është pjesë integrale e mandatit të përgjithshëm të tyre për të siguruar stabilitetin e sistemit financiar dhe për të ruajtur sigurinë në valutën vendore. Në këtë kontekst, bankat qendrore kryejnë një numër funksionesh të ndryshme në zbatimin e kliringu dhe rregullimit të pagesave vendore. Këto funksione mund të përfshijnë angazhimin e drejtpërdrejtë në menaxhimin e sistemeve të kliringut dhe pagesave si dhe në mbikëqyrjen e sistemit të pagesave duke nxjerrë rregulla, parime dhe praktikat më të mira sipas të cilave marrëveshjet për pagesa private funksionojnë. Roli i mbikëqyrjes së sistemit të pagesave nga banka qendrore në thelb të debatit ndërkombëtar dhe të funksionimit shfaqet si kyç në aktivitetin e bankave qendrore.<sup>14</sup>*

*Roli i bankës qendrore është veçanërisht relevant kur shteti është i angazhuar në një reformë gjithëpërfshirëse të sistemi të tij të pagesave. Në këtë rast, banka qendrore luan rolin udhëheqës në zhvillimin e një vizioni për sistemin e reformuar, duke koordinuar zhvillimet më të gjitha grupet e interesit dhe në zbatimin e planit të reformës. Përfshirja e drejtpërdrejtë e bankës qendrore në sistemet e kliringut dhe pagesave ka qenë në të gjitha shtetet, hapi i parë drejt rregullimit të strukturës së përgjithshme dhe funksionimit të sistemi të pagesave të një shteti dhe për të siguruar se dëshira për kufizimin e rrezikut sistematik, veçanërisht në fushën e sistemeve të pagesave në vlera të mëdha, është marrë parasysh në mënyrë adekuate. Në shumë raste, ky rol buron nga nevoja për të siguruar një shfrytëzim më të madh të teknologjisë më të avancuar në mekanizmat e transferimit të fondeve dhe për të shmangur diskriminimin e mundshëm sa i përket qasjes në shërbimet e pagesave. Në të gjitha rastet, më qëllim të ndjekjes së interesit publik në sistemin e pagesave, bankat qendrore duhet të sigurojnë që sistemet sipas të cilave ato funksionojnë të jenë në pajtim me parimet dhe udhëzimet e njëjta të cilat ato i kanë përcaktuar, si mbikëqyrës, për të siguruar efikasitetin dhe siguri (financiare dhe operative) në sistemet e kliringut dhe pagesave me të cilat ato nuk funksionojnë. Roli mbikëqyrës i bankës qendrore mbase më tepër shfaqet në rastet kur reforma e pagesave është përfunduar dhe banka qendrore kërkohet që të sigurojë një monitorim të duhur dhe të vazhdueshëm të sigurisë dhe efikasitetit të sistemit ditor.*

*Në vitet e fundit, në një numër në rritje të shteteve, mbikëqyrja e sistemit të pagesave kryesisht i është besuar bankave qendrore me ligj. Specifikimi i objektivave në legjislacionin relevant është mënyra më e qartë për ofrimin e një baze të shëndoshë ligjore për bankën qendrore në zbatimin e politikave të saj dhe për ta bërë atë llogaridhënëse në përmbushjen e synimit dhe mandatit të saj në sistemin e pagesave. Në shtetet që janë në zhvillim e sipër të një projekti madhor të reformës në sistemin e tyre të pagesave, për bankën qendror është më se e rëndësishme që të ketë një kornizë të bazuar ligjore e cila përcakton qartë rolin e sistemit të pagesave dhe objektivat.*

---

<sup>14</sup> Shembujt e fundit fokusohen në përgjegjësitë e bankës qendrore në raportin e Parimeve Themelore të KSRRP-së dhe në Rekomandimet e KIB/ONKL-së për Sistemet e Pagesave të Letrave me Vlerë si dhe në dokumentin për mbikëqyrjen e sistemit të Pagesave të Bankës së Anglisë. Shikoni gjithashtu Bossone-Cirasino, “Mbikëqyrja e sistemit të pagesave – Korniza për zhvillimin dhe qeverisjen e sistemeve të pagesave në ekonominë në rritje”, që do të publikohet së shpejti në koleksionin e Bankës Botërore.

*Sa i përket fushëveprimi të funksionit të mbikëqyrjes, në nivel ndërkombëtar, ekziston një konsensus për faktin se sistemet të cilat paraqesin rreziqe sistematike duhet që kategorikisht t'i nënshtrohen kontrollit të drejtpërdrejt të mbikëqyrësit. Shembuj tipik të këtyre sistemeve janë ato të cilat merren me transaksionet me vlerë të madhe si në nivelin individual ashtu edhe në atë të përgjithshëm. Për shembull, Grupi Punues i KSRRP-së për parimet themelore ka identifikuar katër përgjegjësi të bankës qendrore në zbatimin e parimeve të përgjithshme për SPSR-në(shiko shtojcën 2).*

*Një vëmendje e shtuar gjithashtu i është kushtuar sistemeve të kliringut dhe pagesave të letrave me vlerë si komponentë relevant të sistemit të përgjithshëm të pagesave. Mbikëqyrja e këtyre sistemeve mund të jetë një orvatjeje bashkërenduese e dy apo më tepër agjencive. Në disa vende edhe sistemet me pakicë (me vlerë të vogël) bien nën kontrollin e agjencisë mbikëqyrëse për shkak të: rëndësisë së tyre në efikasitetin e përgjithshëm të sistemit të pagesave; ndikimit të tyre potencial në besimin e publikut në para; dhe lidhjen e tyre në përmbushjen e objektivit themelor të rritjes së ekonomisë.<sup>15</sup>*

*Evoluimi drejt këtij roli të ri të bankës qendrore në sistemin e pagesave kërkon një shqyrtim të kujdesshëm të së paku tri çështjeve kyçe. Së pari, duhet të vlerësohet përshtatshmëria e mekanizmave zbatues ligjor në aktivitetin e bankës qendrore në sistemin e pagesave. Roli i Bankës Qendrore në sistemet e pagesave kryesisht rrjedh nga përgjegjësia e saj për një stabilitet të tregut financiar. Në shumë shtete, një mekanizëm zbatues ligjor dhe i përcaktuar qartë për aktivitetin e bankës qendrore si mbikëqyrëse e sistemit të pagesave ka ndihmuar në përmbushjen e objektivave të bankës qendrore.*

*Së dyti, organizimi i brendshëm i bankës qendrore për sa i përket aktiviteteve të sistemit të pagesave gjithashtu meriton të vlerësohet. Përvoja në shumë banka qendrore ka tregtuar se mund të bëhen përmirësime të konsiderueshme duke formuar një njësi që në mënyrë të veçantë do t'i përkushtohet çështjeve të politikave të pagesave. Në këtë mënyrë, një njësi e tillë do të hartonte një kornizë të përshtatshme të politikave si dhe mjetet e duhura (psh. mbledhja e të dhënave, inspektimet periodike, etj.) që do të shfrytëzoheshin për vlerësimin e përshtatshmërisë së sistemeve të pagesave individuale. Ky funksion do të mund të ushtrohet në bashkëpunim të ngushtë me funksionin mbikëqyrës bankar, për shembull, i cili ka një nivel të lartë të kompetencës dhe përvojës në shqyrtimin e disa nga çështjet që ndërlidhen me të. Veç kësaj, do të ishte e rëndësishme për atë personel që njësi të ketë shkathhtësitë e duhura. Aspektet tipike që duhet të analizohen në administrimin e funksioneve të mbikëqyrjes përfshijnë, ndër të tjera, rreziqet potenciale që shfaqen nga vend-shkëmbimet e ndryshme, sigurimi i përshtatshmërisë së masave për kontroll të rrezikut, implikimet potenciale të zgjidhjes së procedurave të ngatërruara, si dhe çështjet e efikasitetit.*

*Së treti, duhet të sigurohet një bashkëpunim efektiv ndërmjet mbikëqyrësit dhe aktorëve të tregut, ndërmjet rregullatorëve vendor dhe agjencive mbikëqyrëse ndërkombëtare. Institucionalizimi i marrëveshjeve për shkëmbim informatash mund të zvogëlojë*

<sup>15</sup> Shumë shembuj mund të citohen se një sistem i pagesave joefikase me pakicë mund të ndikojë në aktivitetin ekonomik, për shembull, duke dështuar në adresimin e nevojave të klientëve dhe tregtarëve kur ata dëshirojnë të kryejnë një transaksion, i cili si rezultat i kësaj nuk mund të realizohet.

*rrezikun se shkëmbimi i informatave mund të pengohet nga fërkimet në bashkëpunim ndërmjet institucioneve të ndryshme. Kjo nuk paraqet ndonjë problem në rast se banka qendrore është rregullatori dhe mbikëqyrësi i vetëm i të gjitha institucioneve financiare. Në rast të kundërt (për shembull, nëse themelohet një organi i veçantë për ushtrimin e kompetencave të rregullimit/mbikëqyrjes në tregjet kapitale), atëherë banka qendrore duhet të punojë që të sigurojë një bashkëpunim të plotë me rregullatorin(ët) e tregjeve të letrave me vlerë, pasi që pagesa e letrave me vlerë është pjesë integrale e sistemit të pagesave dhe problemet në kliringun dhe rregullimin e tregjeve të letrave me vlerë lehtë mund të bartën në sistemin e pagesave dhe anasjelltas.*

**Shtylla VIII: Korniza mbikëqyrëse për pagesat dhe sistemet e pagesave të letrave me vlerë është e përcaktuar qartë, dhe BQK-ja ushtron në mënyrë efektive autoritetin e vet**

1. BQK-ja ka për qëllim që të ushtrojë në mënyrë efektive funksionin e mbikëqyrjes së sistemit të pagesave në Kosovë në pajtim me kompetencat specifike të përcaktuara sipas ligjit për bankën qendrore.
2. BQK-ja do të ketë autoritet të qartë legjislativ për mbikëqyrjen sistemeve të kliringut dhe pagesave. Ligji do t'i japë BQK-së autoritet ligjor për të siguruar zhvillimin dhe funksionimin e mekanizmave të pagesave të cilët do të kontribuonin në mënyrë efektive në integritetin, efikasitetin dhe sigurinë e të gjitha tregjeve financiare (shiko shtyllën I).
3. BQK-ja do t'i bëjë publik objektiva dhe politikat e veta në lidhje me të gjithat çështjet e rëndësishme të sistemit të pagesave së bashku me strategjitë për zbatimin e tyre.
4. Sa i përket objektivave të politikës, BQK-ja do të arrijë efikasitet dhe siguri për të gjitha sistemet. BQK-ja gjithashtu do të promovojë konkurrencën në tregun e shërbimeve të pagesave si dhe mbrojtën e interesave të klientëve në bashkëpunim me autoritetet tjera.
5. Sa i përket fushëveprimit të rolit të saj mbikëqyrës, BQK-ja do të mbikëqyrë të gjitha marrëveshjet e kliringut dhe të pagesave në Kosovë, duke përfshirë sistemet me pakicë, pasi që ato janë posaçërisht të rëndësishme në mbështetjen e aktivitetit ekonomik dhe besimit të publikut në para.
6. Në ushtrimin e rolit të saj mbikëqyrës, BQK-ja do të ketë mundësi që të kryejë në mënyrë efikase këtë funksion. Në këtë mënyrë, BQK-ja do të:
  - i) bëjë aranzhime të përshtatshme organizative dhe që ndërlidhen me personelin, duke përfshirë rotacionin e personelit; funksioni i mbikëqyrjes do t'i caktohet një njësie në kuadër të BQK-së dhe të ndarë nga njësitë tjera e cila do të jetë përgjegjëse për funksionimin e sistemeve të ofruara nga BQK-ja;
  - ii) sigurojë se ekziston një shkallë adekuate e bashkëpunimit të pjesëmarrësve dhe se është e mjaftueshme për promovimin dhe realizmin e marrëveshjeve të dëshirueshme organizative dhe operative;
  - iii) verifikojë se sistemet e pagesave individuale i plotësojnë nevojat e shfrytëzuesve si dhe kërkesat për risk dhe efikasitet nëpërmjet intervenimeve të

duhura si në fazën e zhvillimit ashtu edhe gjatë zbatim të vazhdueshëm të sistemit e po ashtu edhe në fazën operative;

iv) përcaktojë dhe zbatojë veprimet e duhura në rast se pjesëmarrësit nuk u përmbahen rregullave dhe rregulloreve të publikuara (d.m.th. zbatimi i dënimeve dhe sanksioneve të paracaktuara në rast mosveprimi në pajtim me to);

v) mbledhë dhe shpërndajë informata statistikore për të demonstruar shfrytëzimin e çdo sistemi dhe shkallën se në çmasë këto sisteme kanë plotësuar nevojat e shfrytëzuesve të drejtpërdrejt the tregjeve tjera. Do të nxirren raportet rreth informatave dhe politikës publike që kanë të bëjnë me çështjet substanciale të sistemit të pagesave në mënyrë që të sigurohet shpërndarja e gjerë e tyre tek grupet e interesit të përfshira në sistemin e pagesave.

## SEKSIONI 1.02 SHTYLLA IX. BASHKËPUNIMI

*Bashkëpunimi efektiv ndërmjet pjesëmarrësve në treg, ndërmjet rregullatorëve dhe pjesëmarrësve në treg si dhe ndërmjet vetë rregullatorëve është esencial në zhvillimin e një sistemi të shëndoshë dhe efikas të pagesave. Në veçanti, elementi ndërlidhës që karakterizon transferimin e parave dhe natyrën sistematike të procedurave themelore operative e bën sistemin pagesave një “institucion” ku ekzistenca dhe funksionimin normal i të cilit kërkon një bashkëpunim efektive ndërmjet të gjithë pjesëmarrësve. Në anën tjetër, shfrytëzimin i instrumenteve të pagesave gjeneron efekte anësore të konsiderueshme sa i përket kërkesës, pasi që dobishmëria e një instrumenti është e lidhur ngushtë me shkallën e pranimit dhe shfrytëzimit për qëllimet e transaksionit. Si pasojë, shfrytëzimi i përhapur i instrumenteve dhe shërbimeve të reja të pagesave mbështeten kryesisht në besimin e publikut në to. Në anën tjetër, brenda sistemit të pagesave, ofrimi i shërbimeve mund të ndikohet nga dështimet në bashkëpunim për shkak të ekzistimit të konflikteve të interesit (dhe kostos së informatave) si dhe mosgatishmëria e ndërmjetësuesve për bashkëpunim. Kjo mund të shpie në një ekuilibrim “nën-optimal” në marrëveshjet organizative për sa i përket sigurisë dhe efikasitetit të sistemit. Në raste të tilla, mbikëqyrësit të sistemit të pagesave i besohet që të përmirësoj një lloj të tillë të dështimit në tregun e shërbimeve të pagesave, d.m.th. dështimet rreth bashkëpunimit.*

*Çështjet e bashkëpunimit mund të jenë posaçërisht relevante brenda sistemeve ndërbankare të kliringut dhe pagesave. Në fakt, në këto sisteme profilet e riskut – si në nivelin e sistemit ashtu edhe në nivelin e ndërmjetësimit individual – mund të mos vlerësohen plotësisht nga pjesëmarrësit. Veç kësaj, brenga se duhet të mbështeten ndërmjetësuesit më pak të sigurt mund t'i shpie pjesëmarrëset e mëdhenj kah diskriminimi i grupeve më të vogla, madje edhe kur ata teknikisht kanë të drejtë të marrin pjesë në sistem. Së fundi, industria e sistemit të pagesave gjithashtu varet nga marrëveshjet ndërmjet prodhuesve me qëllim të sigurimit se komponentët e ndryshëm të sistemit janë në përputhshmëri me njëri tjetrin. Së fundi, shfaqja e formave të reja të ndërmjetësuesve jobankar dhe instrumentet e pagesave kanë shtuar nevojën për një nivel gjithëpërfshirës të bashkëpunimit në sistemin e pagesave.*

*Sa i përket bashkëpunimit ndërmjet rregullatorëve, objektivat e sigurisë dhe efikasitetit të pagesave dhe sistemet e pagesave të letrave me vlerë mund të ushtrohen nga një varg autoritetesh të sektorit publik, përveç bankës qendrore dhe rregullatorit të letrave me vlerë (nëse ekziston). Shembujt e këtyre rregullatorëve përfshijnë: autoritetet legjislative, Ministrinë e Financave dhe autoritetet konkurruese. Gjithashtu ekzistojnë lidhje plotësuese ndërmjet mbikëqyrjes, mbikëqyrjes së bankare dhe mbikëqyrjes së tregut. Bashkëpunimi i duhur mund të arrihet në një varg mënyrash, për shembull, shkëmbimi i pikëpamjeve dhe informatave mund të bëhet duke mbajtur takime të rregullta apo të rastit. Marrëveshjet për shkëmbim të informatave mund të jenë të dobishme për një shkëmbim të tillë.*

### **Shtylla IX: Është vendosur një bashkëpunim efektiv, strukturor dhe frytdhënës brenda KKP-së**

1. Duke marrë parasysh çështje e lartpërmendur, në Kosovë është krijuar KKP-ja (Këshilli Kombëtar i Pagesave) nën udhëheqje e BQK-së. Ky organ ka për qëllim të përfshijë përfaqësuesit e bankave dhe grupeve tjera kryesore të interesit me interes në sistemet e pagesave dhe kliringut dhe pagesave të letrave me vlerë dhe do të jetë jashtëzakonisht i rëndësishëm që gjithashtu të sigurojë një diskutim konstruktiv ndërmjet tyre. Kushtet e Referimit për KKP-në do të përgatitën dhe miratohen nga anëtarët (Shtojca 1 tregon modelin e kushteve të referimit për KKP-në).
2. Strategjia e komunikimit për objektiva dhe politikat e reformës dhe për çdo çështje që ka të bëjë me pagesat dhe sistemet e pagesave, si dhe rolet e ndryshme që do të luhen nga anëtarët e KKP-së në këtë angazhim, do të përcaktohen në frymën e bashkëpunimit.



## **NENI II. SHTOJCAT**

## SEKSIONI 1.02 SHTOJCA 1: MODELI PËR KËSHILLIN KOMBËTAR TË PAGESAVE – KUSHTET E REFERIMIT

### KUSHTET E REFERIMIT PËR KKP

#### Objektivat

Këshilli Kombëtar i Pagesave (KKP) synon të mbështesë themelimin e një sistemi të shëndoshë dhe efikas të pagesave si dhe të sistemeve të kliringut dhe pagesave të letrave me vlerë në Kosovë. Ai gjithashtu mund të shërbejë si një forum bashkëpunimi për mbarëvajtjen rregullit në sistemet e vendore dhe ndërkombëtare të pagesave.

#### Detyrat kryesore

- ◆ KKP-ja punon për të ndihmuar një bashkëpunimin ndërmjet bankave dhe grupeve tjera kryesore të interesit në fushën e pagesave.
- ◆ KKP-ja promovon iniciativa të përgjithshme drejt zbatimit të infrastrukturës së sistemit të pagesave. Këto iniciativa nuk duhet të pengojnë, dhe në fakt duhet të nxisin, konkurrencën e shëndoshë ndërmjet pjesëmarrësve në treg.
- ◆ KKP-ja luan rol kyç në përgatitjen e dokumenteve strategjike për arkitekturën e përgjithshme të sistemit të pagesave në vend.
- ◆ KKP-ja luan rol kyç në monitorimin dhe zbatimin e reformave në sistemet e pagesave.
- ◆ KKP-ja luan rol kyç për të ndihmuar në shkëmbimin e informatave sipas kërkesave ekonomike dhe të afarizmit të palëve të përfshira në sistemin e pagesave.
- ◆ KKP-ja ndihmon në identifikimin e ndikimit të opsioneve të ndryshme në afarizmin e pjesëmarrësve dhe në aktivitetet ditore si dhe në interesat e shfrytëzuesve të drejtpërdrejtë.
- ◆ KKP-ja luan rol kyç në përzgjedhjen e parimeve kryesore dhe opsioneve për dizajnin e sistemit.
- ◆ KKP-ja luan rol kyç në mbështetje e prioriteteve të formave të projekteve individuale që do të fillohen, financohen dhe zbatohen.
- ◆ KKP-ja promovon standardizimin e procedurave dhe sistemeve.
- ◆ KKP-ja është përgjegjëse për promovimin e njohurive të çështjeve të sistemit të pagesave në vend. Në këtë mënyrë, KKP-ja shfrytëzon çdo mjet që mund ta shohë të dobishëm (punëtoritë, seminarët, faqet e internetit, shpalljet, buletinet informative, etj.).
- ◆ KKP-ja kërkon të promovojë bashkëpunimin ndërmjet institucioneve aktive në sistemet e pagesave dhe letrave me vlerë brenda rajonit dhe nivelit ndërkombëtar.

#### Metodologjia

- ◆ KKP-ja përgatit raporte të rastit lidhur me çështje e sistemit të pagesave. Raportet nuk do të jenë të natyrës normative. Megjithatë, ato do të shërbejnë si referim për reformat e sistemit aktual të pagesave në vend.
- ◆ KKP-ja do të formojë grupe punuese sipas rastit lidhur me çështjet e pagesave. Grupet punuese mund ose mund të mos jenë të përbëra krejtësisht nga institucionet e përfaqësuar në KKP.
- ◆ KKP-ja përgatit dhe publikon raporte vjetore lidhur e aktivitetit e tij.

#### Përfaqësimi dhe struktura organizative

- ◆ Bankat dhe grupet tjera kryesore të interesit të përfshira në pagesa dhe sistemet e kliringut dhe pagesave të letrave me vlerë do të përfshihen në KKP. . Fillimisht, do të përshihen: BQK-ja, bankat komerciale, Departamenti i Thesarit i Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave dhe Shoqata e Bankierëve të Kosovës. Anëtarët tjerë potencial mund të jenë institucionet tjera financiare, komisionerët/agjentët, shfrytëzuesit e drejtpërdrejt, dhe kompanitë kryesore (të shërbimeve publike,

telekomunikimit, etj.). KKP-ja ka një strukturë formale me Guvernatorin e BQK-së si kryesues dhe sekretariati i tij sigurohet nga BQK-ja..

- ◆ Përfaqësuesit e caktuar nga grupet e interesit janë kryeshefat e tyre ekzekutivë. KKP-ja do të ftojë një numër të duhur të ekspertëve në takimet e veta. Përbërja e takimeve të KKP-së duhet të jetë në përputhje me objektivat për të siguruar diskutime efektive në takime.
- ◆ Në fazën e hershme të funksionimit të vet, KKP-ja mund të kërkojë, nëse është e nevojshme, ndihmë nga entitetet tjera vendore dhe ndërkombëtare me përvojë të madhe në menaxhimin e grupimeve të sistemit të pagesave.
- ◆ KKP-ja mund të ftojë, nëse është e nevojshme, edhe institucionet dhe/ose ekspertët tjerë individual për të marrë pjesë në takimet e tij.

## SEKSIONI 1.02 SHTOJCA 2: KSRRP - PARIMET THEMELORE PËR SISTEMET E PAGESAVE SISTEMATIKISHT TË RËNDËSISHME DHE PËRGJEGJËSITË QË KANË TË BËJNË ME BANKËN QENDRORE

### PARIMET THEMELORE PËR SISTEMET E PAGESAVE SISTEMATIKISHT TË RËNDËSISHME

- I. Sistemi duhet të ketë një bazë ligjore të përcaktuar mirë në përputhje me legjislacionin relevant.
- II. Rregullat dhe procedurat e sistemit duhet t'ua mundësojnë pjesëmarrësve të kenë një kuptim të qartë të ndikimit të sistemit në secilin nga rreziqet financiare që ata hasin gjatë pjesëmarrjes në të.
- III. Sistemi duhet të ketë procedura të definuara qartë për menaxhimin e rrezikut të kreditit dhe rreziqeve të likuidimit, të cilat specifikojnë përgjegjësitë e operatorit të sistemit dhe të pjesëmarrësve dhe të cilat ofrojnë një shtytje të duhur për të menaxhuar dhe mbajtur ato rreziqe.
- IV. Sistemi duhet të ofrojë kryerjen e shpejtë dhe përfundimtare të pagesave në ditën e çmimit, preferohet gjatë ditës dhe më së largu në fund të ditës.
- V. Një sistem në të cilin paraqitet rrejtë multilateral duhet që, më së paku, të jetë në gjendje të sigurojë kryerjen me kohë të pagesave ditore në rast të pamundësisë së kryerjes së tyre nga ana e pjesëmarrësve që si obligim të vetëm kryesor kanë kryerjen e pagesës.
- VI. Preferohet që për mjetet e shfrytëzuara për pagesa t'i bëhet një kërkesë Bankës Qendrore, ku shfrytëzohen edhe mjetet tjera, dhe ku ato duhet të bartin pak apo fare hiç risk të kredisë dhe pak apo fare hiç risk të likuidimit.
- VII. Sistemi duhet të sigurojë një shkallë të lartë të sigurisë dhe besueshmërisë operative dhe duhet të ketë marrëveshje shtesë për përfundimin me kohë të produkteve ditore.
- VIII. Sistemi duhet të ofrojë një mjet për kryerjen e pagesave, i cili është praktik për shfrytëzuesit e tij dhe efikas për ekonominë,
- IX. Sistemi duhet të ketë kritere objektive dhe të njohura publikisht për pjesëmarrësit, i cili lejon qasje të drejtë dhe të papenguar.
- X. Marrëveshjet për menaxhim të sistemit duhet të jenë efektive, llogaridhënëse dhe transparente.

### PËRGJEGJËSITË E BANKËS QENDRORE NË ZBATIMIN E PARIMEVE THEMELORE

- A. Banka Qendrore duhet t'i definojë qartë objektivat e sistemit të saj të pagesave dhe duhet ta bëjë publik rolin e saj dhe politikat kryesore lidhur me sistemet e pagesave sistematikisht të rëndësishme.
- B. Banka Qendrore duhet të sigurojë se sistemet me të cilat funksionon janë në pajtim me parimet themelore.
- C. Banka Qendrore duhet të mbikëqyrë pajtueshmërinë e sistemeve me parimet themelore në rast të mosfunksionimit dhe duhet të ketë mundësi që ta bëjë këtë mbikëqyrje.
- D. Banka Qendrore, në promovimin e sigurisë së sistemit dhe efikasitetit të sistemit të pagesave nëpërmjet parimeve themelore, duhet të bashkëpunojë me bankat tjera qendrore dhe me autoritetet tjera relevante vendore dhe ndërkombëtare.

## SEKSIONI 1.02 SHTOJCA 3: KSRRP-ONKL - REKOMANDIMET PËR SISTEMET E PAGESAVE TË LETRAVE ME VLERË

### REKOMANDIMET PËR SISTEMET E PAGESAVE TË LETRAVE ME VLERË

Rek. 1 – Sistemet e pagesave të letrave me vlerë duhet të kenë një bazë të përcaktuar qartë dhe transparente në përputhje me legjislacionin relevant.

Rek. 2 – Konfirmimi i angazhimeve tregtare ndërmjet pjesëmarrësve të drejtpërdrejt në treg duhet të bëhet sa me shpejtë që të jetë e mundur pas ekzekutimit të aktivitetit tregtar, por jo me vonë se data e tregtisë (T+0). Në rastet kur kërkohet konfirmimi i angazhimeve tregtare nga ana e pjesëmarrëse të tërthortë në treg (siç janë investitorët institucional), kjo duhet të bëhet sa me shpejtë që të jetë e mundur pas ekzekutimit të aktivitetit tregtar, preferohet në T+0, por jo më vonë se T+1.

Rek. 3 – Pagesat e përsëritura duhet të miratohen në të gjitha tregjet e letrave me vlerë. Pagesa përfundimtare duhet të bëhet jo më vonë se T+3. Përfitimet dhe kostot e ciklit të pagesës më të shkurtër se T+3 duhet të vlerësohen.

Rek. 4 – Përfitimet dhe kostot e palës tjetër qendrore duhet të vlerësohen. Kur paraqitet një mekanizëm i tillë, pala tjetër qendrore duhet t'i kontrollojë në mënyrë rigoroze rreziqet të cilat i merr.

Rek. 5 – Letrat me vlerë për huadhënie apo huamarrje (apo marrëveshjet rreth blerjes dhe transaksionet tjera të barasvlershme ekonomike) duhet të inkurajohen si një metodë për përsheptimin e pagesave të transaksioneve të letrave me vlerë. Pengesat e hasura në praktikën e huadhënies së letrave me vlerë për këtë qëllim duhet të mënjanohen.

Rek. 6 – Letrat me vlerë për aq sa është e mundur duhet të jenë të bllokuara apo të dematerializuara dhe të transferuara në të hyra në libra në DQL.

Rek. 7 – DQL-të duhet të eliminojnë rrezikun kryesor duke lidhur transferimet e letrave me vlerë me transferimet e fondeve në mënyrë që të bëhet dorëzimi kundrejt pagesës.

Rek. 8 – Pagesa përfundimtare duhet të bëhet jo më vonë se fundi i ditës së pagesës. Finalizimi gjatë ditës apo brenda një kohe reale duhet të bëhet e qartë kur nevojitet për të zvogëluar rreziqet.

Rek. 9 – DQL-të që klientëve u ofrojnë kredi brenda ditës, duke përfshirë CSD-të që shfrytëzojnë sistemet e pagesave në rrjet, duhet të bëjnë kontrollin e riskut që, së paku, të sigurojë pagesën me kohë në rast se pjesëmarrësi me obligimin më të madh të pagesës nuk është në gjendje ta kryej atë. Mënyra më e besueshme e kontroleve është një kombinim i kërkesave dhe kufizimeve anësore.

Rek. 10 – Mjetet e shfrytëzuara për kryerjen e obligimeve të pagesës përfundimtare që dalin nga transaksionet e letrave me vlerë duhet të bartin pak apo fare hiç rrezik të kredisë apo likuidimit. Nëse paratë e bankës qendrore nuk shfrytëzohen, duhet të ndërmerren hapa për mbrojtjen e anëtarëve të DQL-së nga humbjet potenciale dhe presionet e likuidimit që rrjedhin nga dështimi i pagesës në kesh nga agjenti mjetet e të cilit janë shfrytëzuar për atë qëllim.

Rek. 11 – Burimet e rrezikut operativ që dalin gjatë procesit të kliringut dhe pagesave duhet të identifikohen dhe minimizohen nëpërmjet zhvillimi të sistemeve, kontroleve dhe procedurave të përshtatshme. Sistemi duhet të jetë i besueshëm dhe i sigurt, dhe të ketë kapacitet adekuat dhe të matshëm. Duhet të krijohen plane dhe pajisje rezervë për të lejuar rifillimin me kohë të veprimeve dhe përfundimin e procesit të pagesës.

Rek. 12 – Entitetet që ruajnë letrat me vlerë duhet të shfrytëzojnë praktikën e llogaritjes dhe procedurat e ruajtjes të cilat mbrojnë në mënyrë të plotë letrat me vlerë të klientëve. Është esenciale që letrat me vlerë të klientëve të mbrohen nga kërkesat e kreditorëve të mbajtësit të tyre.

Rek. 13 – Marrëveshjet qeveritare për DQL-të dhe palët tjera qendrore duhet të përcaktohen me qëllim të përmbushjes së kërkesave të interesit publik dhe për promovimin e objektivave të pronarëve dhe shfrytëzuesve.

Rek 14 – DQL-të dhe palët tjera qendrore duhet të kenë objektiva dhe kritere të njohura publikisht për pjesëmarrje që lejon një qasje të drejtë dhe të papenguar.

Rek. 15 – Përveç zhvillimit të qetë dhe të sigurt të funksionimit, sistemet e pagesave të letrave me vlerë duhet të jenë edhe me kosto të arsyeshme për plotësimin e kërkesave të shfrytëzuesve. .

Rek. 16 – Sistemet e pagesave të letrave me vlerë duhet të shfrytëzojnë dhe përshtatin procedurat relevante të komunikimit ndërkombëtar më qëllim të lehtësimit të pagesës efektive të transaksioneve tej kufitare.

Rek. 17 – DQL-të dhe palët tjera në nivel qendror duhet t’ju ofrojnë pjesëmarrëseve në treg informata të nevojshme që në mënyrë saktë të identifikojnë dhe vlerësojnë rreziqet dhe kostot që ndërlidhen me shfrytëzimin e DQL-së apo shërbimet e palëve tjera qendrore.

Rek. 18 – Sistemet e pagesave të letrave me vlerë duhet t’i nënshtrohen rregullimit dhe mbikëqyrjes transparente dhe efektive. Banka Qendrore dhe rregullatorët e letrave me vlerë duhet të bashkëpunojnë më njëri-tjetrin dhe me autoritetet tjera relevante.

Rek. 19 – DQL-të cilat krijojnë lidhjet për rregullimin e tregtisë tej kufitare duhet t’i dizajnojnë dhe fusin në funksion lidhjet e tilla me qëllim të zvogëlimit në mënyrë efektive të rreziqeve të ndërlidhura pagesat tej kufitare..

## SEKSIONI 1.02 SHTOJCA 4: KSRRP – PARIMET E PËRGJITHSHME TË BANKËS BOTËRORE PËR SHËRBIMET E DËRGESAVE NDËRKOMBËTARE DHE ROLET QË NDËRLIDHEN ME TO

### PARIMET E PËRGJITHSHME PËR SHËRBIMET E DËRGESAVE NDËRKOMBËTARE

Parimet e përgjithshme synojnë krijimin e objektivave të interesit publik për ofrimin e shërbimeve të sigurt dhe efikase të dërgesave ndërkombëtare. Në këtë mënyrë, tregjet e shërbimeve duhet të jenë konkurruese, transparente, të qasshme dhe të shëndosha..

#### Transparenca dhe mbrojtja e klientëve

**Parimi i përgjithshëm 1.** Tregu i shërbimeve të dërgesave ndërkombëtare duhet të jetë transparent dhe të ofrojë mbrojtje adekuate për klientët.

#### Infrastruktura e sistemit të pagesave

**Parimi i përgjithshëm 2.** Duhet të inkurajohet infrastruktura e sistemit të pagesave e cila ka potencial të shtojë efikasitetin e shërbimeve të dërgesave ndërkombëtare.

#### Mjedisi ligjor dhe rregullues

**Parimi i përgjithshëm 3.** Shërbimet e dërgesave ndërkombëtare duhet të mbështeten nga një kornizë e shëndoshtë, e parashikueshme, jodiskriminuese ,proporcionale, ligjore dhe rregulluese sipas juridiksioneve relevante.

#### Struktura e tregut dhe konkurrenca

**Parimi i përgjithshëm 4.** Kushtet konkurruese të tregut, duke përfshirë qasjen e duhur në infrastrukturë, duhet të krijohen në industrinë e pranimit të dërgesave ndërkombëtare.

#### Qeverisja dhe menaxhimi i rrezikut

**Parimi i përgjithshëm 5.** Shërbimet e dërgesave ndërkombëtare duhet të mbështeten nga menaxhimi i duhur dhe praktikat e menaxhimit të rrezikut.

### ROLET E OFRUESVE TË SHËRBIMET DËRGESAVE NDËRKOMBËTARE DHE AUTORITETET PUBLIKE

**A. Roli i ofruesve të shërbimeve të dërgesave ndërkombëtare.** Ofruesit e shërbimeve ndërkombëtare duhet të marrin pjesë në mënyrë aktive në zbatimin e parimeve të përgjithshme.

**B. Roli i autoriteteve publike.** Autoritetet publike duhet të vlerësojnë se çfarë veprimesh duhet të ndërmerren për të përmbushur objektivat e interesit publik nëpërmjet zbatimi të parimeve të përgjithshme.

## SEKSIONI 1.02 SHTOJCA 5: SYNIMET E INTERESIT PUBLIK, VEPRIMET MINIMALE TË BANKËS QENDRORE DHE SFERA E VEPRIMEVE TË MUNDSHME PLOTËSUERE PËR SISTEMET E PAGESAVE ME PAKICË<sup>16</sup>

### *Korniza ligjore dhe rregulluese*

#### **Synimi i interesit publik A:**

Politikat që kanë të bëjnë me sigurinë dhe efikasitetin e pagesave me pakicë duhet të krijohen, sipas nevojës, **për të adresuar pengesat ligjore dhe rregulluese në zhvillimin dhe sjelljen e risive në treg.**

#### **Banka Qendrore duhet që së paku të:**

- (i) Rishikojë kornizën ligjore dhe rregulluese për të identifikuar çdo pengesë në përmirësimin e efikasitetit dhe/apo sigurisë;
- (ii) Bashkëpunojë me entitetet relevante publike dhe private më qëllim që struktura ligjore dhe rregulluese të mbajë hapin me rrethanat ndryshuese dhe të mënjanoen, sipas nevojës, pengesat në përmirësimet e efikasitetit dhe/apo sigurisë.

**Sfera e veprimeve të mundshme plotësues** mund të përfshijë, varësisht nga përgjegjësitë e Bankës Qendrore individuale, këto kompetenca dhe prioritete:

- Ndryshimin e rregulloreve që aktualisht paraqesin pengesa në përmirësimin e efikasitetit dhe sigurisë, kur kjo është në kuadër të fushëveprimit të Bankës Qendrore dhe kur argumentet tjera të interesit publik nuk janë në kundërshtim me një veprim të tillë;
- Paraqitja apo propozimi i rregulloreve të reja, siç lejohet sipas fushëveprimit të Bankës Qendrore, ku korniza ligjore dhe rregulluese është e pamjaftueshme për të mbështetur efikasitetin dhe/apo sigurinë e shtuar;

### *Struktura e tregut dhe performaca*

#### **Synimi i politikës publike B:**

Politikat që kanë të bëjnë me sigurinë dhe efikasitetin e pagesave me pakicë duhet të krijohen, sipas nevojës, **për të ngritur kushtet e tregut dhe sjelljet.**

#### **Banka Qendrore duhet që së paku të:**

- (i) Monitorojë zhvillimet në kushtet e tregut dhe sjelljet që kanë të bëjnë me instrumentet e pagesave me pakicë dhe shërbimeve dhe të bëjë vlerësimin e rëndësisë së tyre;
- (ii) Bashkëpunojë me entitetet relevante publike dhe private sipas nevojës, me qëllim të ngritjes së kushteve të tregut konkurrues dhe për të adresuar ndonjë çështje të rëndësishme të interesit publik që rrjedhin nga strukturat e tregut dhe performanca.

**Sfera e veprimeve të mundshme plotësues** mund të përfshijë, varësisht nga përgjegjësitë e Bankës Qendrore individuale, këto kompetenca dhe prioritete:

- Promovimin e standardeve apo udhëzimeve të duhura për transparencë, në bashkëpunim me entitetet relevante nga sektori publik dhe privat;
- Rishikimin e kushteve në tregun e pagesave tej kufitare me pakicë, duke pasur parasysh promovimin e përmirësimeve, nëse një veprim tillë është i garantuar;

<sup>16</sup> Ekstrakt i përmbledhjes Banka për Pagesa Ndërkombëtare, Komisioni për Sistemet e Pagesave, *Çështjet e Politikës për Bankat Qendrore në Pagesat me Pakicë* (Mars 2003).



- Shqyrtimin dhe, sipas nevojës, intervenimin operativ dhe rregullues në rastet kur forcat e tregut janë të gjykuara që të mos arrijnë apo pritet të mos arrijnë një zgjidhje efikase dhe të sigurt.

### *Standardet dhe infrastruktura*

#### **Synimi i interesit publik C:**

Politikat që kanë të bëjnë me sigurinë dhe efikasitetin e pagesave me pakicë duhet të krijohen, sipas nevojës, **për të mbështetur zhvillimin e standardeve dhe rregullimeve infrastrukturore efektive.**

#### **Banka Qendrore duhet që së paku të:**

- (i) Monitorojë zhvillimet e standardeve të sigurisë, standardeve operative dhe rregullimeve infrastrukturore për pagesa me pakicë të cilat Banka Qendrore i vlerëson të jenë të rëndësishme për interesin publik, dhe të bëjë vlerësimin e rëndësinë e tyre;
- (ii) Bashkëpunojë me entitetet relevante publike dhe private për të inkurajuar përmirësimet e tregut sipas standardeve dhe rregullimeve infrastrukturore, sipas nevojë.

**Sfera e veprimeve të mundshme plotësues** mund të përfshijë, varësisht nga përgjegjësitë e bankës qendrore individuale, këto kompetenca dhe prioritetet:

- Pjesëmarrjen aktive në rishikimin dhe zhvillimin e standardeve dhe marrëveshjeve të duhura, në bashkëpunim me entitete relevante publike dhe private, atëherë kur banka qendrore vlerëson se përfshirja e saj më intensive është e nevojshme në arritjen e synimit;
- Shqyrtimin dhe, sipas nevojës, intervenimin operativ dhe rregullues në rastet kur forcat e tregut janë të gjykuara që të mos arrijnë apo pritet të mos arrijnë një zgjidhje efikase dhe të sigurt.

### *Shërbimet e Bankës Qendrore*

#### **Synimi i interesit publik D:**

Politikat që kanë të bëjnë me sigurinë dhe efikasitetin e pagesave me pakicë duhet të krijohen, sipas nevojës, **për ofrimin e shërbimeve të Bankës Qendrore në mënyrën me efektive për tregun e veçantë.**

#### **Banka Qendrore duhet që së paku të:**

- (i) Rishikojë dhe, sipas nevojës, të përshtatë ofrimin e shërbimeve të pagesave për të kontribuar në rezultate efikase dhe të sigurta;
- (ii) Jetë transparente në ofrimin e shërbimeve.

**Sfera e veprimeve të mundshme plotësues** mund të përfshijë, varësisht nga përgjegjësitë e Bankës Qendrore individuale, këto kompetenca dhe prioritetet:

- Rishikimin e shërbimeve relevante jo rregulluese të cilat i ofron dhe marrjen parasysh të adaptimit të tyre në kushtet e tregut në ndryshim;
- Rishikimin e politikave për qasje në shërbimet e Bankës Qendrore dhe në caktimin e çmimeve.

**NENI II. LISTA E SHKURTESAVE**

VSHA	Vendshkëmbimi i Automatizuar
AIMK	Asociacioni i Institucioneve Mikrofinanciare të Kosovës
ATM	Bankomat
KIB	Kodet Identifikuese të Bankës
BPN	Banka për Pagesa Ndërkombëtare
ABPK	Autoriteti Bankar dhe i Pagesave i Kosovës
AQBK	Autoriteti Qendror Bankar i Kosovës
BQK	Banka Qendrore e Republikë së Kosovës
KSRRP	Komisioni për Sistemet e Rregullimit të Pagesave
RKK	Regjistri i Kredive të Kosovës
DQL	Depozitimi Qendror i Letrave me Vlerë
DvP	Dorëzimi kundrejt Pagesës
SEKN	Sistemi Elektronik i Kliringut Ndërbankar
ASK	Asociacioni i Sigurimeve të Kosovës
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
ONKL	Organizata Ndërkombëtare për Komisionet e Letrave e me Vlerë
KKPN	Komisioni Këshillues për Pagesa Ndërbankare
ABK	Asociacioni i Bankierëve të Kosovës
NLLBK	Numri i Llogarisë Bankare në Kosovë
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës (ndërmarrje publike për furnizimin me energji elektrike)
IM	Institucioni Mikrofinanciar
OJQ	Organizata Joqeveritare
KKP	Këshilli Kombëtar i Pagesave
SKP	Sistemi Kombëtar i Pagesave
(TEF)PSH	(Transferimi Elektroni i Fondeve) Pika e Shitjes
OTC	Over the Counter

PTK	Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës (ndërmarrje)
PvP	Pagesa kundrejt Pagesës
BPKR	Bruto Pagesa në Kohë Reale
SPSR	Sistemi i Pagesave Sistematikisht të Rëndësishme
OV	Organizata Vetërregulluese
PD	Procedimi i Drejtpërdrejtë
TPL	Autopërgjegjësia ndaj palës së tretë (për sigurimin e automjeteve)
UNMIK	Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë